

Ombudsmani
Prokuroritë
nuk i përfillin
institucionet

Fq.5



FORUM


A do të ketë
pazar, Ligji për
gjuhët për
amnistinë?

Fq.11



Karriera
"e bekuar"
e Kingslej
Koman

Fq.21



Koha

www.koha.mk



KOHA për
kulturë

Fq.12-15

EDITORIAL

**Kumanova
tjetër**



Në diplomaci, gjeopolitikë por edhe në letërsi, ekzistojnë nocione metagjuhësore brenda një shpjegimi socio-psikologjik. Zakonisht na ka rënë të dëgjojmë a lexojmë për sintagmën "Amerika tjetër", ose "Europa tjetër", përkufizime këto që mëtojnë të na nxjerrin nga shabllonet e betonuara semantike, në një realitet më pak të njohur, por shumë i qenësishëm në instrumentariumin e domosdoshëm...

Fq.2

RAJON

**Dekada e
shkeljeve
kushtetuese**

Fq.16

GLOBI

**Spiuni që çoi
në këmbë
gjithë botën!**

Fq.17

FORUM

Dhunë!

Fq.10



ALEANCA PËR SHQIPTARËT ZGJODHI ORGANET E REJA PARTIAKE

EMRA TË VJETËR NË KRYESINË E RE



Nënkryetarë të partisë do të vazhdojnë të jetë Elmi Aziri nga Kumanova dhe Remzi Memedi nga Kërçova, Vullnet Ferati nga Tetova dhe Bujare Abazi nga Çairi. Shefi i kabinetit i kryetarit të partisë Ziadin Sela pritet të zgjidhet ish-nënkryetari Agon Ferati, ndërsa zëdhënës Flakron Bexheti. Të njëjtit do të zgjidhen në mbledhjen e parë të kryesisë së re, ndërsa sekretar i përgjithshëm mbetet Arben Taravari

Fq.3

Të gatshëm të korrigojmë propozim-ligjin

Shkup, 9 prill - Teksti i propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës si variant i mundshëm për nxjerrjen e Ligjit të ri të arsimit të lartë në Maqedoni ka gjasa të pësojë ndryshime të tjera. Zyrtarë të lartë të MASH-it nuk përjashtojnë aspak këtë mundësi. Madje, sikurse deklaroi zëvendësministri Arbër Ademi, nëse konsiderohet e nevojshme, MASH është e gatshme të pranojë ndryshime, dhe nëse duhet - edhe lar-

gimin e ndonjë neni nga varianti i tanishëm i propozim-ligjit në fjalë, për të cilin tha se është përgatitur në bashkëpunim të plotë me komunitetin akademik, pasi inkluziviteti ka qenë një prej parimeve bazë të ndërmarrjes për ndryshimin e legjislatives arsimore të nivelit të lartë. "Kemi besuar dhe vazhdojmë të besojmë se vetëm në partneritet të pashkëputur me komunitetin akademik, mund ti..."

Fq.6



EDITORIAL

KUMANOVA TJETËR



Emin AZEMI

Në diplomaci, gjeopolitikë por edhe në letërsi, ekzistojnë nocione me tagjuhësore brenda një shpjegimi socio-psikologjik. Zakonisht na ka rënë të dëgjojmë a lexojmë për sintagmën "Amerika tjetër", ose "Europa tjetër", përkufizime këto që mëtojnë të na nxjerrin nga shabllonet e betonuara semantike, në një realitet më pak të njohur, por shumë i qenësishëm në instrumentariumin e domosdoshëm të njohurive që fshihen pas tabuve që i krijojmë vetë ne. Ata që kanë pa filma vestern në të kaluarën, bie fjala, e që nuk kanë mundur ta vizitojnë dhe ta njohin Amerikën nga afër, do të kenë mundur të krijojnë përshtypje se gjithë amerikanët janë kauboj.

Gjithashtu, shumë kush që vitet e fundit ka dëgjuar e lexuar për Kumanovën, mund të ketë rënë pahetueshëm në grackën e perceptimit të gabueshëm se ky është një vilajet i errët, i destinuar të prodhojë vetëm kriza, probleme e incidente, e çka jo tjetër. Por, në fakt është edhe një "Kumanovë tjetër", një Kumanovë e njerëzve punëtorë e bujar, e profesorëve e mjekëve të dalluar, e atyre që shohin punët e tyre, por që janë shumë pak të pranishëm në kronikat që i krijon politika e keqe dhe mediat senzacionale.

Të ndodhur në një udhëkryq hapësirash e historish dhe të ballafaquar me furtunat që vinin nga Veriu e Lindja, shqiptarët e Kumanovës, ata që ngelën, sepse një numër i madh i tyre u shpërngul në Turqi, në vitet pesëdhjetë e gjashtëdhjetë, dhe ata që erdhën nga fshatrat përreth (këndej dhe andej kufirit), u munduan të krijojnë identitetin e tyre etno-social në planin kolektiv e homogjen, por pa ndonjë sukses, ndërkohë që në planin individual (si shumë kund që ndodhë në hapësirën shqiptare) ata projektuan botën e tyre të suksesit e prestigjit, duke konkurruar bindshëm në një hapësirë më të gjerë kombëtare e ndërkombëtare.

Mosarritja e harmonizimit të objektivave kolektive me ato individuale, i ka bërë shqiptarët e Kumanovës të jenë shumë heterogjen në prirjet e tyre për organizim dhe aktivizim shoqëror dhe për rrjedhojë të jenë shumë të ekspozueshëm ndaj autoriteteve e ndikimeve të jashtme, duke e shndërruar jo rrallë sinqeritetin e tyre në një "monedhë" tepër të lirë, me të cilën po paguajnë koston e një imazhi që pameritueshëm i identifikon ata.

Klanet e krijuara, jo mbi afinitete cilë-

sish profesionale, intelektuale e qytetare, por mbi interesa ordinere, të atyparatyshme dhe në kundërshtim me të gjitha nevojat e aspiratat që kanë banorët e kësaj zone, ka kohë që janë bërë pengesë e zhvillimit normal të jetës komunitare politike, kulturore e sociale në Kumanovë. Instalimi pa sens dhe pa kriter i strukturave drejtuese lokale politike, tash e mbi dy dekada në rajonin e Kumanovës po regjeneron në vazhdimësi krizë dhe vetëm krizë.

Zakonisht nëse një defekti ndodhë në fillim dhe i njëjti tolerohet me vite, patjetër që do të sjellë një havori edhe më të madhe. Dhe havoria më kolosale që ka ndodhur në Kumanovë, në këto dekada tranzicion demokratik, është lënia jashtë proceseve e individëve e familjeve me taban kombëtar e me biografi profesionale e intelektuale dhe futja në lojë e aktorëve që vetën e dëshmuar se nuk ishin të përgatitur për maratona të gjata, se ata ishin futur shumë shpejt në garën e madhe të përgjegjësive e obligimeve. Janë po këta aktorë që brenda një harku kohor i ndryshuan klanet, qëndrimet, interesat. Janë po këta aktorë që refuzuan prurjet e reja të njerëzve të rinjë, që janë më të ditur se ata. Janë po këta aktorë që përfaqësojnë Kumanovën në nivele qendrore dhe ata janë përcaktuesit e fatit edhe të atyre që dinë më shumë se ata.

Ata që e njohin pak Kumanovën, janë viktimë e perceptimit të gabueshëm për këtë zonë. Mbase përgjegjësia për mosnjohjen e mjaftueshme të Kumanovës bie edhe mbi liderët partiakë, të cilët shtrirjen organizative të partive politike e bëjnë sipas një metodologjie shumë të njëtrajtshme që sipërfaqësinë dhe fokusimin brenda një rrethi të ngushtë njerëzish e kanë pranuar si metodën e tyre të vetme. Poqese bëhet një hulumtim pak më i imtësishtëm dhe kjo shtrirje ndjek një skenim më të thellë të gjendjes, do të shohim se në pah do të delë një Kumanovë krejtësisht tjetër, një Kumanovë e profileve e biografive konkurruese në një treg më të gjerë dijesh e afinitetesh.

Prandaj, ju që mendoni se na përfaqësoni dhe ju që vini shpejt e shpejt të na tregoni se kush vlen e kush nuk vlen këtu, është mirë ta studioni pak më detajisht këtë zonë, të nxirri mësim nga pësimet e kaluara dhe të mbështetni politikën tuaj kadrovike mbi merita e jo mbi inate, mbi tru e jo mbi muskuj.

Sepse, Kumanova është krejt tjetër...

KUSHTETUTA QË VULOSI KOSOVËN SHTET

"Pas çlirimit të Kosovës, shpalljes së Pavarësisë, themelimi i Kushtetutës së vendit është ndër datat më të rëndësishme të kalendarit tonë shtetëror. Me 9 Prill të vitit 2008, Kosova vendosi themelet e saj të konsolidimit si shtet, duke e funksionalizuar aktin më të lartë juridik, Kushtetutën e saj. Një dekadë më parë, përmes këtij dokumenti, u vulos Kosova jonë si vend i pavarur, me qytetarë të lirë me të drejta të barabarta për secilin, në frymën e pakufizuar demokratike. Dekada e parë e Kushtetutës së vendit, krahas qenësimit tonë si shtet juridik, ka përjetuar edhe sfidat e saj. Këto sfida, na tregojnë edhe vlerat tona demokratike si shoqëri kur ne kemi pranuar këto parime kushtetuese si parime udhëheqëse të Kosovës. Sot, ky bazament ligjor shpërfaqë vlerat më të larta të demokracisë tonë. Përvjetori i sivjem, i shtyllës kryesore ligjore të vendit, na gjen me plot detyra. Na gjen me punë, me suksese të numëruara por edhe sfida për t'i tejkaluar e që na bëjnë më të fortë. Por, mbi të gjitha, ky jubile na gjen më të sigurt se kurrë, për rrugën tonë Euro-atlantike dhe miqësinë e përhershme me SHBA-të. Urime 9 Prilli, Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës!", shkruan në profilin e tij në FB, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj.

UDHËRRËFYES PËR KRIJIMIN DHE FORCIMIN E SHTETIT

"Kushtetuta e Republikës së Kosovës sot shënon dekadën e parë. Si udhërrëfyes për krijimin dhe forcimin e shtetit, ajo pasqyron më së miri përpjekjet shekullore për liri, barazi e drejtësi dhe dëshmon vendosmërinë për të ndërnuar një të ardhme të përbashkët në paqe të qëndrueshme. Asnjëherë nuk do të ndalemi së punuari për të forcuar shtetin, duke respektuar të drejtat e liritë e çdo qytetari dhe duke garantuar barazinë e tyre para ligjit", shkruan në profilin e tij në FB, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

TË HAPIM NEGOCIATAT ME SHQIPËRINË

"Javën e kaluar vizitova sërish Shqipërinë. Konkluzioni im është i qartë: Ne duhet të hapim menjëherë negociatat me këtë shtet. Progresi është bërë, por mendoj edhe shumë punë ka për të bërë, pa dyshim. Jam vërtetë i inkurajuar nga të rinjtë që takova në Tiranë, në shkollë, në qendrën sociale Bregu i Lumit dhe në Universitetin e Durrësit. Ata të gjithë duan mbështetjen tonë, për të sjellë Shqipërinë më pranë Europës. Ne mund të kemi opinione të ndryshme, në lidhje me shumë vendime politike, por me këta të rinj në Tiranë, është vërtetë me vlerë të punosh", shkruan në profilin e tij në Facebook, anëtari i Parlamentit Europian, Knut Fleckenstein.



MEDIACitate

Aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për rastin e njohur si "Pronto", në të cilin janë të përfshirë persona që bartin ose kanë bartur funksione të larta zyrtare, vjen në kohën kur Kosova duhet të dëshmojë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si kusht nga Bashkimi Evropian për liberalizimin e vizave, thonë njohësit e zhvillimeve në Kosovë. Por, sipas tyre, karakteristikat që përmban kjo aktakuzë, më shumë është, siç e kanë quajtur ata, "hedhje hi syve" ndaj bashkësisë ndërkombëtare, se sa një qasje e sigurt në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në aktakuzën e Prokurorisë Speciale është përfshirë ish-shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Adem Grabovci, si dhe 10 persona të tjerë me funksione të larta zyrtare. Të pandehurit akuzohen për vepër penale, se kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare duke bashkëpunuar ndërmjet vete, për dhënie të privilegjeve dhe përparësive të kundërligjshme për personat, të cilët kanë konkurruar në funksione të rëndësishme. Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, thotë për Radion Evropa e Lirë, se aktakuza i referohet një neni që nuk hyn në kuadër të veprave penale të korrupsionit. Madje, sipas tij, kjo aktakuzë ka amnistuar persona që vazhdojnë të jenë zyrtarë të lartë të Kosovës, e të cilët ishin të përfshirë në rastin e njohur si "Pronto". "Aktorët kryesorë, të cilët kanë pasur pushtet, kanë pasur fuqi ekzekutive, për kryerjen e kësaj veprë penale, nuk janë futur fare në këtë aktakuzë, përfshirë këtu edhe presidentin e republikës (Hashim Thaçi), i cili në atë kohë ka ushtruar funksionin e kryeministrit të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, më shumë shihet si amnisti ndaj pozitave kryesore në Republikën e Kosovës dhe në anën tjetër, si një aktakuzë sa për t'i hedhur 'pluhur syve' popullit dhe bashkësisë ndërkombëtare, se kinse Prokuroria është e pakompromis në luftimin e veprave penale", thekson Miftaraj. Mendim të ngjashëm ka edhe Artan Demhasaj nga Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet "Çohu". Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai shpreh dyshimin se kjo aktakuzë ndërlidhet me kushtin për liberalizimin e vizave për Kosovën - luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

(REL, 9 prill)

NËSE NUK E KENI DITUR...

ÇFARË ËSHTË TESTI IQ?

Testi IQ (nga anglishtja Intelligence Quotient) IQ, me një fjalë të vetme është niveli i inteligjencës. Treguesi i inteligjencës, pra IQ, është treguesi që mat përafërsisht inteligjencën e një personi në lidhje me pjesën tjetër të njerëzimit. IQ-ja e çdo personi matet me metoda të ndryshme, metoda që përfshin zakonisht



test me pyetje ose përpunimi i objekteve të ndryshme. Me gjithë ndryshimet e tyre në modele, këto teste masin një formë të inteligjencës, kryesisht logjikën dhe të menduarin induktiv dhe jo fantazinë, vendosmërinë, inteligjencën instiktive dhe të tjera që mund të plotësonin imazhin e inteligjencës së dikujt.

Nënkryetar të partisë do të vazhdojnë të jetë Elmi Aziri nga Kumanova dhe Remzi Memedi nga Kërçova, Vullnet Ferati nga Tetova dhe Bujare Abazi nga Çairi. Shefi i kabinetit të kryetarit të partisë Ziadin Sela pritet të zgjidhet ish-nënkryetari Agon Ferati, ndërsa zëdhënës Flakron Bexheti. Të njëjtit do të zgjidhen në mbledhjen e parë të kryesisë së re, ndërsa sekretar i përgjithshëm mbetet Arben Taravari

ALEANCA PËR SHQIPTARËT ZGJODHI ORGANET E REJA PARTIAKE



EMRA TË VJETËR NË KRYESINË E RE

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 9 prill - Me pak prurje të reja nga doktorë shkencash dhe me disa ish-eksponentë të lartë të PDSH-së, karakterizohet Kryesia e re 20 anëtarëshe e Aleancës për Shqiptarët, e cila u zgjodh nga Kuvendi Qendror. Sekretar i përgjithshëm i partisë është rizgjedhur Arben Taravari, aktualisht kryetar i Komunës së Gostivarit, ndërsa katër nënkryetarët do të zgjidhen nga Kryesia Qendrore në mbledhjen e parë të saj. Nga Aleanca për Shqiptarët, sipas burimeve të sigurta partiake, nënkryetar të partisë do të vazhdojnë të jenë Elmi Aziri nga Kumanova dhe Remzi Memedi nga Kërçova, ndërsa në vend të Agon Feratit që ishte më herët nga Dega e Tetovës, nënkryetar i partisë do të jetë Vullnet Ferati, ish-kandidati zyrtar i kësaj partie për ministër të Shëndetësisë pas dorëheqje se Arben Taravari për shkaktim të kandidimit për kryetar të Gostivarit. Nënkryetar i katërt do të jetë Bujare Abazi, inxhinieri e post-telekomunikacionit dhe bartëse e listës për këshilltarë në zgjedhjet e fundit lokale për Komunën e Çairit. Dega më e përfaqësuar në parti është ajo e Gostivarit me pesë anëtarë, edhe atë Halil Snopçe, Etem Aziri, Ismet Rramani, Arben Taravari dhe Mujdin Biladhi. Po sipas këtyre burimeve, ish-nënkryetari

Agon Ferati pritet të zgjidhet shefi i kabinetit të kryetarit të partisë, Ziadin Sela, ndërsa për zëdhënës është paraparë njëri ndër eksponentët më të theksuar në opinion, Fakron Bexheti, që deri më tani ishte anëtar kryesisë dhe ka luajtur edhe rolin e zëdhënësit të partisë. Por moszgjedhja e tij nga Kuvendi Qendror ka shkaktuar pakënaqësi nga një pjesë e strukturave të Degës së Tetovës edhe përkundër faktit se më statutin e ri partiak, zëdhënësi i partisë me automatizëm është edhe anëtar i Kryesisë qendrore.

Veç tjerash, befasuese është edhe mos futja në kryesi e dy personave shumë të rëndësishëm nga Dega e Likovës, ish bartësi i listës për deputetë Nexhmedin Sadiku dhe ish-kandidati për kryetar i Komunës së Likovës, Bekim Afuzi, të cilët drejtpërdrejt kanë ndikuar në rritjen e votave në këtë komunë dhe kanë qenë pothuajse njerëzit kryesor në strukturimin e partisë në të gjitha fshatrat e kësaj komunë.

Nexhmedin Sadiku ishte edhe drejtor në Qendrën e e Provimeve Shtetërore gjatë kohës që Aleanca për Shqiptarët ishte në pushtet. Duke që këta të dy janë sakrifikuara për Rijad Shaqirin, djalin e ish-deputetit dhe ish-nënkryetarit të Parlamentit, Hysni Shaqiri, i zgjedhur anëtar i Kryesisë qendrore në Kuvendin Qendror. Të pa përfaqësuar

Befasuese është edhe mos futja në kryesi e dy personave shumë të rëndësishëm nga Dega e Likovës, ish bartësi i listës për deputetë Nexhmedin Sadiku dhe ish-kandidati për kryetar i Komunës së Likovës, Bekim Afuzi, të cilët drejtpërdrejt kanë ndikuar në rritjen e votave në këtë komunë dhe kanë qenë pothuajse njerëzit kryesor në strukturimin e partisë në të gjitha fshatrat e kësaj komunë

në Kryesinë qendrore mbetëm edhe dy degët e komunave që kanë kryetarë nga radhët e Aleancës për Shqiptarët, ajo e Bogovinës dhe Vrapçishtit.

Anëtarët tjetër të kryesisë janë edhe Qerim Mahmuti nga Saraji, ish-drejtor i burgut të Idrizovës, Arta Toçi, ish-zëvendësministre e Punëve të Jashtme, Syrjia Rashidi deputet nga Struga, Garip Kaba nga Struga, Lirim Demiri nga Tetova, Bedri Beadini nga Tearca, Bajram Aliu nga Prilepi, Ilire Dauti dhe Bekim Pocesta nga Dibra, Zylfi Adili ish-sekretar shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë...

Një element tjetër po aq befasues është edhe përzgjedhja e drejtorit të Akademisë Politike, edhe atë profesori universitar Halil Snopçe nga Gostivari, për faktin

se i njëjti është i thirrur për shkencat kompjuterike, ndërsa ka doktoruar në matematikë e jo në shkencat politike siç do të duhej të ishte një udhëheqës i një shkollë politike dhe siç praktikohet në vendet tjera, ndërsa nga ana tjetër profesori universitar në shkencat politike Etem Aziri është zgjedhur kryetar i Komisionit statusor-juridik, dhe të dy janë nga Dega e Gostivarit dhe me automatizëm - do të jenë edhe anëtar të Kryesisë.

Po me automatizëm anëtar të Kryesisë qendrore do të jetë dhe kryetarja e Forumit të Gruas dhe kryetari i Forumit Rinor, me çka dhe përbërja e Kryesisë nga 20 sa janë aktualisht, do të shtohet deri në 30 anëtarë, në mesin e të cilëve do të jenë edhe përfaqësues nga diaspora.

JASHTË QEVERISË

Ndryshe në mbledhjen e Kuvendit Qendror, Aleanca për Shqiptarët doli me dy konkluzione, njëri në mbështetje të faktorit ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjes së emrit, tjetri se kjo parti nuk do të bëhet pjesë e Qeverisë pa iu nënshtuar zgjedhjeve parlamentare. "Kuvendi i Aleancës për Shqiptarët pas diskutimeve në lidhje me situatën aktuale politike në Maqedoni, solli edhe dy konkluzione: 1. Aleanca për Shqiptarët do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e faktorit ndërkombëtar dhe Qeverisë së Maqedonisë për zgjidhjen e çështjes së emrit, duke mbajtur qëndrimin inkurajues, por duke rikujtuar të gjitha palët e involvuara në proces se emërtimi i ri duhet të jetë i përkthyesëm ndërkombëtarisht dhe assesi nuk duhet të asocojë njëanshëm në gjuhën dhe

alfabetin vetëm të një etniteti të caktuar në vend. Në këtë formë, zgjedhja e këtij problemi shumëvjeçar do të pasqyrojë realitetin multi-etnik të vendit dhe do të luajë rol të rëndësishëm në ndërtimin e paqes, stabilitetit dhe tolerancës afatgjatë në vend. 2. Aleanca për shqiptarët njofton opinionin publik se në asnjë formë nuk do të jetë pjesë e ndonjë përbërjeje të re qeveritare, të cilës nuk do ti paraprijë procesi zgjedhor parlamentar. Ky vendim unanim i ASH-së bazohet në indikacionet se kjo garniturë qeverisëse nuk është mjaftueshëm bindëse në angazhimin e saj për reforma rrënjësore në vend dhe sidomos në indiferencën e saj rreth sjelljes dhe zbatimit të parimeve dhe funksionalizimit të shtetit ligjor", thuhet kështu në njoftimin për media të ASH-së.

Java e ligjeve reformuese

Shkup, 9 prill - Pas festimit të Pashkëve, në ditët në vijim deputetët do të vijnë me hapa përfundimtare para publikimit të Raportit për avancimin e vendit në Komisionin Evropian më 17 prill. Prej sot (e martë), intensifikohet agjenda si në planin e brendshëm, ashtu edhe në jashtëm për marrjen e raportit sa më pozitiv të mundshëm, i cili do të përmbante rekomandim për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE. Në Parlamentin e Maqedonisë për sot janë caktuar katër seanca parlamentare me

pika të mbetura dhe disa mbledhje në rend dite të së cilës janë ligjet reformuese. Në seancën e 34-të janë ligji reformues për gjykatat, në seancën e 35-të janë plotësimet e Ligjit për prokurori publike dhe Ligjit për procedurë penale, në lexim të dytë është caktuar seanca e 22-të me një pikë të mbetur, ndryshime dhe plotësime të Ligjit për mbrojtje të dëshmitarëve, me procedurë të shkurtuar. Është caktuar edhe seanca e 41-të me disa pika të cilat nuk janë nga pakoja reformuese. Pritet të enjten ose

eventualisht të premten të caktohet edhe një seancë parlamentare në të cilën në rend dite do të jenë pakoja e ligjeve për ndjekjen e komunikimeve. Komunikimi parlamentar për mbrojtje dhe siguri, në të cilën në rend dite janë propozimet e ligjeve për ndjekje të komunikimeve dhe për OTA, të dy në lexim të dytë dhe ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për armë, para festave të Pashkëve është shtyrë për të martën, 10 prill.

Këto janë pjesë e ligjeve për të cilat grupet e punës të VMRO-

DPMNE-së opozitare dhe shumica qeveritare në Parlament, sipas shprehjeve të liderëve të partisë dhe personave zyrtarë, kanë arritur harmonizim. Në ndërkohë, në Parlament, siç paralajmëroi kryetari i VMRO-DPMNE-së, të mërkurën duhet të mbahet seancë për votimin e besimit të Qeverisë. Caktimi i kësaj seance para asaj plenare për ligjet reformuese ishte një kusht për pjesëmarrjen e deputetëve të VMRO-DPMNE-së në Parlament dhe votim për ligjet reformuese. Partia opozitare nuk merr pjesë në

punën e parlamentit pas paraburgimeve për gjashtë deputetët e saj dhe qytetarëve tjerë për dhunën në Parlament më 27 prill. Më 12 prill, ndërsa, vijon takimi i ri bilateral midis ministrave të Punëve të Jashtme të Maqedonisë dhe të Greqisë, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxias në Ohër për gjetjen e zgjidhjes për kontestin për emrin. Paraprakisht Dimitrov dhe Koxias patën takim në Vjenë, pas të cilit kryeministri Zoran Zaev tha se është optimist dhe vlerësoi se ka lëvizje përpara.

NIKOS MERXIAS PËR KONTESTIN
ATHINË-SHKUP

MARRËVESHJE TË NDESHME PËR EMRIN



"Mirë do të ishte të jetë në gjuhën tuaj. Por, nëse një vend i huaj, dëshiron ta përkthejë emrin për shembull North Macedonia, që do të bëjmë? Do ta padisim", komenton Merxos

Athinë, 9 prill - Nevojitet të gjendet zgjidhje të problemit me emrin, ndërsa me një marrëveshje të ndershme, nuk do të ekzistojnë kurrfarë dyshime, thotë në bisedë me korrespondentën e MIA-s nga Athina, Nikos Merxias, shkrimtar, historian, gazetar grek, ish-këshilltar i disa kryeministrave grekë dhe ish-kryetar i "Shoqatës greke për studime maqedonase".

"Nevojitet të gjendet zgjidhje. Saktë. Kjo duhet të përfundojë që në vitin 1992-1993. Atëherë bisedova unë me Gligorovin, ishim shumë afër. E dyta, duhet të stabilizohet edhe shteti juaj dhe shteti ynë. Për shkak se këto gjëra janë të lidhura mes vete. U them, Vardari mbërrin deri në Selanik, në rregull, ne njërin gjysmë e quajmë Aksios, por është lumi i njëjtë. Duhet të gjejmë zgjidhje dhe njëri popull të mos e lëndojë tjetrin popull. Posaçërisht më i fuqishme të mos e lëndojë më të dobëtin, por edhe më i dobëti të tregojë mirëkuptim, të tregojë miqësi të vërtetë. Unë jam i sigurt, jam i bindur, me marrëveshje të

ndershme, për 20 vite nuk do të ekzistojnë kurrfarë dyshime", shpjegon Merxos. Ai në periudhën e kaluar, përmes teksteve dhe fjalimeve në Greqi, bën thirrje që të zgjidhet problemi, ndërsa qëndrimi i tij përputhet me atë të qeverisë greke - marrëveshje me emër të përbërë.

"Zgjidhja duhet të jetë me emër të përbërë. Ne themi se Maqedonia është greke, unë jam maqedonas - grek, Borisov është maqedonas - grek. Ka hebrej - maqedonas. Ju dëshironi monopol, vetëm identifikohuni siç dëshironi, por të dallohet njëri nga tjetri", thotë Merxos në bisedë me korrespondentën e MIA-s nga Athina. Lidhur me atë se nëse emri duhet të jetë në gjuhën maqedonase, pa përkthim, sipas shkrimtarit grek do të ishte mirë të jetë ashtu, por nuk është diçka e detyrueshme.

"Mirë do të ishte të jetë në gjuhën tuaj. Por, nëse një vend i huaj, dëshiron ta përkthejë emrin për shembull North Macedonia, që do të bëjmë? Do ta padisim",

komenton Merxos. Në mars të vitit 2016, rreth studentë maqedonas, së bashku me shtatë profesorë me qëllim të njohjes më të mirë, ndërtim të besimit dhe miqësisë, midis të rinjve, por edhe vendosje të bashkëpunimit midis bashkësive akademike, ishin për vizitë treditore në Selanik, me ftesë të organizatës joqeveritare "Shoqatë për studime maqedonase", njeri i parë i të cilës, në të kaluarën, ishte pikërisht Merxos. Duke u përqendruar në vizitën treditore, ai thotë se ka qenë shumë e dobishme dhe ka dërguar mesazh miqësor drejt Greqisë. "Ishte përvojë shumë e mirë. Sepse mesazhi nuk ishte drejt studentëve, mesazhi ishte drejt Greqisë, dhe për këtë kam shkruar edhe tani, kur dolën me flamuj. U them jemi fqinj, dëshironi - nuk dëshironi të jetojmë bashkë", thotë gazetari dhe shkrimtari grek dhe potencoi se është e dobishme që më shpesh të mbahen takime të këtilla. Ata për të cilët Merxos thotë se "dolën me flamuj", në fakt janë demonstrue-

sit që në Selanik dhe Athinë "mbronin emrin Maqedonia", ndërsa të cilët Merxos, siç thotë për MIA-n, i fton që gjatë fundjavës të vijnë në Selanik që shetiten dhe të shohin se shumica janë turistë nga Maqedonia të cilët aspak nuk kanë për qëllim ta "lirijnë Selanikun".

Sipas mediave në Greqi, Merxos ka qenë një prej organizatorëve të protestave për Maqedoninë në vitin 1992, 26 vite më vonë, nuk i mbështetën demonstratat në Selanik dhe Athinë dhe në mënyrë të vazhdueshme thotë, të njëjtën atë që e thotë edhe për MIA-n, se nevojitet të arrihet marrëveshje me emër të përbërë. Para dy javëve, Nikos Merxos, në MPJ-në greke e promovoi librin e tij të ri "Çështja e Maqedonisë, ndërsa në promovimin, siç atëherë publikoi MIA, folën shefi i diplomacisë greke Nikos Koxias, ish-zëvendëskryeministri dhe ministër i Punëve të Jashtme Evangelos Venizelos dhe lideri i partisë Potami Stavros Teodorakis.

Mediat greke komentojnë intervistën e Zaevit

Athinë, 9 prill - Onlajn edicionet e mediave greke në tekstin e marrë nga agjencia greke e lajmeve për intervistën e kryeministrit të Maqedonisë për MIA-n dolën me titull si: "Zaev: Mos-hyrje në NATO, nëse nuk zgjidhet çështja për emrin", "Zaev: Takim me Ciprasin do të thotë zgjidhje vijuese"; "Zaev përjashton anëtarësim në NATO pa zgjidhje të emrit"; "Zaev: Nëse takohem me Ciprasin, do të thotë se gjetëm zgjidhje për emrin"; "Nëse dëgjoni për takim me Ciprasin, zgjidhja për çështjen e Shkupit është e sigurt". Siç njofton korrespondentja e MIA-s nga Athina, agjencia greke e lajmeve ANA-MPA, i transmeton qëndrimet e kryeministrit Zaev të lidhura me bisedimet për emrin, anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe takimi eventual me Aleksis Cipras. ANA-MPA në fillim të tekstit me titull "Zaev: IRJM nuk mund të integrohet në NATO, nëse nuk zgjidhet kontesti për emrin", shkruan për atë se kryeministri "e përjashton mundësinë për anëtarësim të vendit të tij në NATO, nëse paraprakisht nuk zgjidhet çështja për emrin". "Zoran Zaev vlerësoi se në takimin e fundit që e kishin në Vjenë më 30 mars, ministrat e Punëve të Jashtme të Greqisë dhe IRJM-së, është bërë progres i rëndësishëm në negociatat për gjetje të zgjidhjes së çështjes për emrin dhe vlerësoi se në takimin e ri që do ta kenë ministrat e punëve të jashtme të së dy vendeve në Ohër, më 12 prill, do të mund të ekzistojnë epilogje pozitive që do të mund të sjellin edhe deri në takim të tij me kryeministrin e Greqisë, Aleksis Cipras", publikoi agjencia greke e lajmeve. Teksti nga ANA-MPA, publikuar paradite, e ndërmorën pothuajse të gjithë edicionet elektronike të mediave greke, por pa analiza ose komente plotësuese.



KOXIAS INTERVISTË PËR GAZETËN GJERMANE "SHPIGEL"

PROBLEMET ME SHKUPIN MUND TË ZGJIDHEN ME GUXIM

Athinë, 9 prill - Dallimet me Shkupin mund të zgjidhen me guxim, thotë ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, Nikos Koxias në intervistë për gazetën gjermane "Shpigel". "Dallimet me Shkupin janë probleme me karakter historik, me identitet,

me trashëgimi dhe kulturë. Këto çështje janë të ndjeshme. Por, mund të zgjidhen me guxim, siç po bëjmë tani. Derisa, madje, me Turqinë kemi probleme me pretendime gjeostrategjike dhe gjeopolitike", thotë shefi i diplomacisë greke

në intervistë për gazetën gjermane. Pothuajse e gjithë intervista e Koxiasit për "Shpigel" i është kushtuar relacioneve greko-turke, njofton korrespondentja e MIA-s nga Athina.

Lidhur me dy ushtarët grekë të

arrestuar më 2 mars nga autoritetet turke, pasi për shkak të motit të keq gabimisht kanë kaluar në territor turk në afërsi të Evros, ndërsa ende janë në burg në qytetin Odrin, Turqi, Koxias thotë se në zyrën e tij ka dokumente për qindra raste të

ngjashme me ushtarë për të cilët ka ekzistuar kthim pa "eskalam të tillë". "Për herë të parë një incident, kur disa ushtarë kaluan 10 metra nga kufiri, trajtohet si tentim që të zhvillohet në krizë, ndërsa madje në raste të ngjashme, me dekada kishite këmbime", thotë ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë. Ai shton se sjellja e Turqia ka ndryshuar, ndërsa kjo nuk është mirë, për shkak se, "edhe ushtarë të tyre do të humben, siç çdoherë ndodhte kohë pas kohe, ndërsa e dyta sepse kjo nuk është sjellje e një aleati në NATO". Shefi i diplomacisë greke shpjegon se rasti me tetë ushtarët turq është i ndryshëm nga rasti me dy ushtarët grekë, për shkak të ushtarët turq kërkuar azil në Greqi, ndërsa autoritetet greke nuk i arrestuan, ndërsa madje ushtarët nga Greqia nuk kërkuar azil në Turqi dhe u arrestuan jo sipas vullnetit të tyre.

OMBUDSMANI NË NJË VIJË ME MEDIAT

PROKURORITË NUK I PËRFILLIN INSTITUCIONET

Zyra e Avokatit të Popullit i ka rekomanduar që Prokurorive të vendit që në të ardhmen të rrisin nivelin e bashkëpunimit me Ombudsmanin dhe të njëjtit t'ia sigurojnë të gjitha dëshmitë, të dhënat dhe informacionet, pavarësisht shkallës së besueshmërisë, respektivisht krijimin e mundësive për zhvillim të mirëfilltë të procedurave

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 9 prill - Prokuroria Publike e Maqedonisë nuk bashkëpunon me zyrën e Avokatit të Popullit. Pavarësisht detyrimit ligjor, siç thuhet në Raportin e Avokatit të Popullit, ankesat për punën e Prokurorive nuk mundet të shqyrtohen në mënyrë të mirëfilltë për shkak të zvarritjes së procedurave nga këto organe të rëndësishme për sundimin e ligjit në vend. Sipas të dhënave të publikuara në Raportin e fundit të Ombudsmanit, Prokuroria Publike në vend të sigurimit të të gjitha provave apo informacioneve, përkundër nivelit të besueshmërisë, gjegjësisht krijimit të kushteve për zhvillimin e procedurave, ata dorëzojnë përgjigje formale.

"Të gjitha prokuroritë në vend, pa asnjë përjashtim, ndaj të gjitha kërkesave tona për ankesat që i kemi pranuar, na japin përgjigje jo të plotë dhe skajshmërisht të papërshtatshme. Në të shumtën e rasteve, përgjigjet e tyre janë 'në bazë të padisë penale ende po veprohet dhe se pas mbledhjes së të gjitha dëshmitë, do të miratohet vendim i duhur nga Prokuroria'. Nga këto përgjigje aspak nuk mund të vërtetohet si, kur, kush dhe çfarë veprime individuale ka ndërmarë, duke filluar nga dita e parashtrimit të kallëzimit penal. Njëkohësisht, nuk mund të vërtetohet karakteri i arsyeve, (objektive apo subjektive) se pse ende nuk është miratuar një vendim prokuroria", thuhet në raportin e fundit të Avokatit të Popullit.

Me këtë qëndrim indiferent, jo profesional dhe të pjesërishtëm të Prokurorisë Publike, krahas zyrës së Avokatit të Popullit, një kohë të gjatë përballen edhe mediat. Vonimi i përgjigjeve, mos përgjigja në kohë, arsyetime të palogjikshme e kështu me radhë, paraqesin vetëm një pjesë të përvojës së hidhur të cilët shumë gazetarë e kanë përjetuar në raport me Prokurorinë Publike të Maqedonisë. Fatkeqësisht, një praktike e tillë vazhdon të zbatohet përkundër paralajmërimeve se



me zgjedhjen e kryeprokurorit të ri Lubomir Jovevski, transparenca dhe bashkëpunimi me mediat dhe organizatat joqeveritare do të jetë në një nivel më të lartë. Zyra e Avokatit të Popullit, në raportin e fundit të punës i ka rekomanduar Prokurorive të vendit që në të ardhmen të rrisin nivelin e bashkëpunimit me Ombudsmanin dhe të njëjtit t'ia sigurojnë të gjitha dëshmitë, të dhënat dhe informacionet, pavarësisht shkallës së besueshmërisë, respektivisht krijimin e mundësive për zhvillim të mirëfilltë të procedurave.

Për dallim nga vitet e mëhershme, në raportin e vitit 2017 të publikuar nga Ombudsmani, thuhet se numri më i madh i ankesave (pothuajse se gjysma) lidhet me mbrojtjen e lirisë të qytetarëve në procedura për përmbarrim, të cilat zhvillohet nga përmbarruesit.

Në rubrikën e jurisprudencës, Ombudsmani e ka konfirmuar një dukuri shqetësuese të cilën shumë avokatë vazhdimisht e përmendin e që lidhet me anulimin e shpesh të seancave gjyqësore dhe mos respektimin e parimit të "gjykimit në afat të duhur". Duke i numëruar shkaqet më të shpeshta të cilët ndikojnë në prolongimin e seancave gjyqësore, Avokati i Po-

pullit thekson se ato vijnë si pasojë arsyeve objektive dhe atyre subjektive. "Konkretisht, prolongimi i seancave gjyqësore bëhet për shkak të ndërrimeve të shpesh të gjykatësve. Anulimet e seancave dhe të shqyrtimeve kryesore po ashtu janë bërë për shkak të mungesës së kushteve për vazhdimin e tyre, tejkalimi i detyrës zyrtare me mos veprimin në kohë të funksionit gjykatë dhe lejimin e keqpërdorimit të të drejtave, për të cilët palët dhe të autorizuarit e tyre i kanë", thuhet në raportin e Avokatit të Popullit. Arsyet shtesore se pse gjyqësori kësaj radhe është renditur në majë të ankesave në zyrën e Avokatit të Popullit, janë edhe veprimet joprofesionale të administratës së gjyqësorit, të cilës siç thotë Ombudsmani, shpeshherë i shkelin dispozitat e Rregullores së gjykatave për administratorët.

Me qëllim që në të ardhmen këto lëshime të mos përsëriten, Ombudsmani ka rekomanduar hetime të plota dhe vërtetim të përgjigjesive individuale për mos respektim të parimit "gjykim në afat të duhur", shkelje këto të cilat burojnë nga mos veprimet profesional dhe jo të ndërgjegjshëm të funksionarëve në sistemin e gjyqësorit.

SULMOHET PARA OBJEKTIT HOTELIERIK NË QENDËR

Një burrë është sulmuar fizikisht nga katër persona tani për tani të panjohur pas mosmarrëveshjes paraprake që ka ndodhur mbrëmë para një objekti hotelierik në bulevardin "Shën Klimenti i Ohrit" në Shkup. Siç kumtoi MPB-ja, incidenti ka ndodhur mbrëmë në orën 02:00, ndërsa në Sektorin për punë të brendshme Shkup e ka paraqitur I.C. (47) menjëherë pasi është sulmuar. Merren masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Rrahjet, shantazhohet dhe vidhet për shkak të një statusi në Fejsbuk

Shkup, 9 prill - Banori i Prilepit I.R. (37) fizikisht ka sulmuar, shantazhuar dhe vodhi një bashkëqytetar të tij për shkak të një statusi në Fejsbuk kundër tij. Siç informon MPB, B.M. (36) ka denoncuar se dje rreth orës 19 derisa ka ecur në këmbë në rrugën "Llazo Filiposki" e ka goditur automjeti i udhë-

tarëve "Jugo", nga i cili ka dalë I.R. (37) së bashku me edhe një person. Kanë filluar t'i kanosen lidhur me një status në "Fejsbuk" të cilin ai e ka shkruar për I.R., me ç'rast fizikisht e kanë sulmuar. B.M. ka arritur të ikë dhe ka hyrë në njërin nga shtëpitë në afërsi, ndërsa pas tij kanë hyrë edhe dy perso-

nat dhe kanë vazhduar ta godasin, ndërsa I.R. i ka kërkuar të holla, ia ka marrë pasaportën dhe i ka thënë që të nxjerrë gjithçka nga xhepat. Pronarja e shtëpisë ka thënë se do të thërrasë polici dhe në atë moment sulmuesit kanë ikur. Po ndërmerren masa për ndriçim të plotë të rastit.

KRONIKË

Rrahje në Taor të Shkupit, sulmohet një polic

Në fshatin Taor të Shkupit dje ka ardhur deri në prishje të rendit dhe qetësisë midis S.D. (23), G.D. (32) dhe D.D. (63) nga njëra anë dhe L.D. (65) nga ana tjetër. Siç informoi MPB-ja, gjatë grindjes S.D. me sëpatë është drejtuar drejt L.D., por nuk e ka qëlluar. Pastaj D.D. dhe S.D. fizikisht e ka sulmuar L.D. pas çka ai është lënduar dhe është dërguar në klinikën "Nënë Tereza". Rasti është paraqitur në polici dhe kanë intervenuar nëpunësit policorë nga Stacioni policor Draçevë. D.D. e la sulmuar njërin prej policëve. Personat janë arrestuar në stacionin policor dhe pas zbardhjes së plotë dhe dokumentimit të rastit do të parashtrohet padi adekuate.

Tetovari sulmohet me armë para shtëpisë së tij

Një person i panjohur e ka goditur me armë K.M. (61) nga f. Bogovinjë të Tetovës para shtëpisë së tij, pasi e ka kishte pyetur pse e kishte goditur automjetin e dhëndrit të tij. Siç informoi MPB-ja, K.M. (61) nga fshati Bogovinjë, rajoni i Tetovës se dje rreth orës 20:30 në shtëpinë e tij ka ardhur një person i panjohur dhe ka trokitur në derën e shtëpisë së tij dhe pasi ka dalë personi e ka pyetur pse e ka goditur automjetin e dhëndrit të tij, pas çka ka nxjerrë armën dhe e ka goditur në pjesën e gojës. K.M. i është dhënë ndihmë mjekësore në Qendrën mjekësore në Tetovë, prej ku është dërguar në kompleksin e klinikave "Nënë Tereza" - Shkup. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Një vajzë kafshohet nga një qen në Karposh

Një vajzë 13-vjeçare dje është kafshuar nga një qen rotvajler në rrugën "Mitropolit Teodosij Gologanov" në parkun për qen në lagjen e Karposhit. Siç informoi MPB-ja, vajza ka marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa babai i saj D.D. (43) i cili ka tentuar ta largojë qenin ka marrë lëndime të lehta trupore. Të lënduarve u është dhënë ndihmë mjekësore në kompleksin e klinikave "Nënë Tereza". Rastin dje në orën 22:30 minuta është paraqitur në Sektorin për punë të brendshme Shkup.

Sulmohet një polic në Gjorçe Petrov

Shkupjani S.R. (27) në lagjen Gjorçe Petrov të Shkupit mbrëmë ka sulmuar një polic, i cili ka dashur ta legjitimojë. Siç kumtoi MPB-ja, mbrëmë në orën 22:25 në rrugën "Novoproektirana" në lagjen e Gjorçe Petrovit, pas procedurës paraprakisht të paraqitur kundër S.R., nëpunësit policorë nga Stacioni policor Gjorçe Petrov kanë kërkuar që ai të legjitimohet. S.R. ka refuzuar të legjitimohet dhe e ka sulmuar njërin prej policëve, pas çka është arrestuar në stacionin policor. (O.Xh)

JAJME SHKURT

Hapësirë për qëndrim të fëmijëve me paralizë cerebrale

Shkup, 9 prill - Nga java e ardhshme, 40 fëmijë nga Qendra për fëmijë me paralizë cerebrale do të zhvendosen në objekt të ri të përkohshëm afër SHF "11 Tetori" i cili është në pronësi të komunës Qendër. "Për shkak të ndërtimit të shkollës së re në lagjen Kapishtec, ka pasur nevojë për dislokim të Qendrës. Por edhe kushtet për qëndrim të fëmijëve në objektin e deritanishëm nuk ishin në nivelin e nevojshëm", kumtoi komuna e Qendrës. Lokacioni i ri është me sipërfaqe prej 250 metrave katrorë dhe është tërësisht i adaptuar për qëndrim të këtyre personave. Është ndërtuar një platformë për qasje deri te rruga. Ky objekt do të jetë këndi i tyre për qëndrim, rekreacion dhe argëtim në periudhën deri në ndërtimin e shkollës. Hapësira e re është në pajtim me standardet për qasje, lëvizje dhe shërbim të personave të cilët lëvizin me pajisje me tualete adekuate të përshtatshme. Objektin, komuna e Qendrës do t'ia dorëzojë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, e cila duhet ta zhvendos pajisjen. Fëmijët do të kenë mbështetje fizioterapeutike dhe defektologjike sipas të gjitha parimeve dhe standardeve. Pas ndërtimit, ata marrin në shfrytëzim 300 metra katrorë hapësirë dhe kushte më bashkëkohore në shkollën e re "Kapishtec".

SHSSH shënoi Ditën botërore të Shëndetësisë

Tetovë, 9 prill - Shoqëria Stomatologjike Shqiptare në Tetovë organizoi mbrëmje festive me rastin e Ditës Botërore të Shëndetësisë. Krahas mbrëmjes festive për nder të ditës së shëndetësisë, janë ndarë edhe mirënjohje për kontribuuesit e deritashëm që me dëshirë e përkushtim i ndihmuan kësaj shoqërie që të jetë krenari e veçantë për të gjitha arritjet në fushën e stomatologjisë në përgjithësi dhe të asaj shqiptare në veçanti. Poashtu mirënjohje është ndarë edhe për rektorin e Universitetit të Tetovës, Vullnet Ameti, dhe individë tjerë që kanë kontribuar për Shoqërinë Stomatologjike Shqiptare. Mbrëmja festive është shoqëruar edhe program argëtues.

Për 8 vjet, 15.000 nxënës më pak

Shkup, 9 prill - Ndonjëherë 4000, ndonjëherë 2000 ose 500... Secilin vit shkollor mungojnë një numër i madh nxënësish që janë regjistruar në arsimin fillor në vitin vijues, dhe nuk e kanë mbaruar shkruan Fakulteti.mk. Sipas të dhënave të Entit shtetëror për statistikë të Maqedonisë (ESHSM), për regjistrimin dhe mbarimin e arsimit fillor në një vit shkollor, thuhet se për tetë vite janë "zhdukur" 14.958 filloristë. Ekspertët e demografisë thonë se pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve kanë braktisur Maqedoninë bashkë me familjet e tyre.

ARSIMI I LARTË, ADEMI PAJTOHET MË VËREJTJET

TË GATSHËM TË KORRIGJOJMË PROPOZIM-LIGJIN

Duke iu referuar kërkesave të shumta për ndryshime në propozim-ligjin aktual të arsimit të lartë, zëvendësministri i Arsimit thotë se MASH është e hapur për ndryshime. "Po shoh se mund të dakordohemi që disa prej atyre zgjidhjeve ligjore të ofruara me propozim-ligjin aktual, duhet të korrighjohen, ndërsa disa duhet të modifikohen e disa duhet edhe të eliminohen tërësisht", shprehet Ademi



Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 9 prill - Teksti i propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës si variant i mundshëm për nxjerrjen e Ligjit të ri të arsimit të lartë në Maqedoni ka gjasa të pësojë ndryshime të tjera. Zyrtarë të lartë të MASH-it nuk përjashtojnë aspak këtë mundësi. Madje, sikurse deklaroi zëvendësministri Arbër Ademi, nëse konsiderohet e nevojshme, MASH është e gatshme të pranojë ndryshime, dhe nëse duhet - edhe largimin e ndonjë neni nga varianti i tanishëm i propozim-ligjit në fjalë, për të cilin tha se është përgatitur në bashkëpunim të plotë me komunitetin akademik, pasi inkluziviteti ka qenë një prej parimeve bazë të ndërmarrjes për ndryshimin e legjislatives arsimore të nivelit të lartë.

"Kemi besuar dhe vazhdojmë të besojmë se vetëm në partneritet të pashkëputur me komunitetin akademik, mund ti bëjmë dhe mund ti realizojmë ndryshimet e duhura. Komuniteti akademik e di më së miri se cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohemi sot dhe cilat janë sfidat e së ardhmes, duke pasur parasysh zgjidhjet aktuale ligjore", shprehet Ademi. Duke iu referuar kërkesave të shumta për ndryshime në propozim-ligjin aktual të arsimit të lartë, ai thotë se MASH si propozues i këtij propozim-ligji është i hapur për ndryshime.

"Po shoh se mund të dakordohemi që disa prej atyre zgjidhjeve duhet të korrighjohen, disa duhet të modifikohen e disa duhet edhe të eliminohen tërësisht", shprehet zëvendësministri Ademi. Dhe, rastet që paraqesin sfidë për ministrinë nuk janë të pakta. Jo më larg se para katër ditëve, në debatin e hapur që u zhvillua në Parlament, u kërkuar që Ligji i ri për arsim të lartë të ofrojë zgjidhje për çështjen e magjistraturave dhe doktoraturave në kuadër të programeve studimore në gjuhën shqipe në Universitetin "Kirili dhe Metodi" në Shkup. Konkretisht, në Katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, në

Fakultetin "Blazhe Koneski" dhe në Fakultetin Pedagogjik "Klimenti i Ohrit" në UKM, studentët shqiptarë duhet ti mbrojnë në maqedonisht punimet e magjistraturës dhe doktoraturës edhe pse edhe kanë studiuar në gjuhën shqipe, edhe pse mentorët dhe anëtarët e komisioneve për mbrojtjen e titujve janë shqiptarë. Ish-ministri i Arsimit dhe Shkencës, aktualisht rektori i Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, Aziz Pollozhani, kërkoi që të rregullohet me Ligji kjo çështje. "Sepse, nëse përdorimi i drejtë i gjuhës shqipe do të mbetet edhe më tej në mëshirën e universiteteve, në këtë rast të UKM-së, nuk do të rregullohet asnjëherë", konsideron Pollozhani, i cili ka mbajtur postin e ministrit në periudhën e viteve 2002-2006. Meqë përdorimi i shqipes në institucionet e larta arsimore nuk ishte rregulluar sikurse duhet as me Ligjin e asaj kohe, ish-ministri Pollozhani iu drejtuar me një shkresë Rektoratit të UKM-së. Në raste të caktuara, ishte mundësuar që magjistraturat të Katedrën e gjuhës shqipe të mbrohen në gjuhën shqipe, mirëpo me ndryshimin e raporteve politike, u ndryshuan edhe situatat duke u thirrur në Statutin e UKM-së, i cili cakton që temat e magjistraturës dhe doktoraturës të përkthehen dhe të mbrohen në gjuhën maqedonase. Të njëjtat kondita vlejnë edhe për përdorimin e shqipes në diplomatin e Katedrës të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe për programet shqipe të Fakultetit Pedagogjik në UKM. Edhe pse propozim-ligji aktual lejon ndarjen e diplomave në dy gjuhë (maqedonisht dhe shqip), kjo pamundësohet nga Statuti i UKM-së, prandaj sfidë konkrete e MASH-it është të kërkojë

ARBËRADEMI

Kemi besuar dhe vazhdojmë të besojmë se vetëm në partneritet të pashkëputur me komunitetin akademik, mund ti bëjmë dhe mund ti realizojmë ndryshimet e duhura. Komuniteti akademik e di më së miri se cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohemi sot dhe cilat janë sfidat e së ardhmes, duke pasur parasysh zgjidhjet aktuale ligjore

me Ligj rregullimin e kësaj çështje për të gjitha universitetet, të cilat kanë programe studimore në gjuhën shqipe, apo në gjuhën të cilën e flasin më tepër se 20 për qind e popullatës. MASH ka gjithashtu rastin të dëshmojë se mund të ofrojë zgjidhje të drejtë ligjore edhe duke korrighjuar nenin 144 të propozim-ligjit aktual, me të cilin kërkohet që në programet ku studiohen në gjuhë jo maqedonase, përveç lëndës të gjuhës maqedonase, të zhvillohen gjithashtu në gjuhën maqedonase të paktën edhe dy lëndë të tjera profesionale.

Përtej sfidave gjuhësore, para se Ligji të miratohet në Parlament, kërkohen ndryshime edhe sa i takon ndarjes së pusheteve, modeleve të financimit, trajtimin e barabartë të të trija cikleve të studimit apo edhe kriterëve për karrierë akademike. Në gjykimin e zëvendësministrit të Arsimit, Arbër Ademi, teksti i propozuar nga MASH garanton autonominë universitare si në aspektin akademik, kadrovik, financiar dhe organizativ - ashtu sikurse ofron liri akademike, mendim të pakufizuar shkencor, mundësi të barabarta dhe parime demokratike. Por krahas këtyre elementëve të vlerësuar si mjaft pozitive edhe nga masa e gjerë, Ademi veçon si tejet të rëndësishme edhe ndërtimin e mekanizmave për forcimin e cilësisë, konkretisht themelimin e Agjencisë të Cilësisë dhe Këshillin Nacional të Arsimit të Lartë. Gjithashtu, e rëndësishme, sipas tij, është se fakultetet do të kenë mundësi të punësojnë asistentë dhe demonstratorët sipas nevojave të tyre. Qëllimi është që përmes këtyre punësimeve të pengohet "ikja e turrit" dhe që në të njëjtën kohë të krijohen rrethana lehtësuese për shtimin e hulumtimeve shkencore.

FAKTORINGU, SI ALTERNATIVË FINANCI MI



Factoringu si mënyrë alternative e financimit të biznesit dhe mos-vonesës së pagesave ndërmjet palëve biznes shumë pak përdoret në Maqedoni, ndërkohë që në Kosovë sidomos ndërmjet bujqve individual dhe grumbulluesve, ai paraqet një storie suksesi

KOSOVA MË E AVANCUAR SE MAQEDONIA

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 9 prill - Për dallim nga Maqedonia, ku faktoringu si mënyrë alternative e financimit të biznesit dhe mos-vonesës së pagesave ndërmjet palëve biznes shumë pak përdoret, në Kosovë sidomos ndërmjet bujqve individual dhe grumbulluesve, ai paraqet një storie suksesi.

Me faktoringun, si burim financimi afatshkurtër për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, bizneset kanë mundësi që menjëherë ti paguajnë faturat dhe jo të presin më gjatë se 120 ditë, mund të sigurojnë kapital të freskët për veprimtarinë e tyre, të paguajnë furnizuesit dhe punëtorët dhe të orientohen në zhvillim të biznesit dhe jo në mbijetesën e tij.

KOMPANITË SHQIPTARE NUK KANË BESIM TË PËRDORIN FAKTORINGUN

Sipas drejtorit të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimor, Drilon Iseni, kompanitë tek ne në përgjithësi shumë pak e përdorin faktoringun, ndërsa kompanitë shqiptare aspak nuk e përdorin atë. "Në radhë të parë, faktoringu në praktikë kërkon një marrëveshje trepalëshe ndërmjet bizneseve dhe institucionit përkatës që të jetë i suksesshëm dhe më vonë nuk ka mundësi që kërkesat financiare të barten tek palat e tretë. Pra nevojitet që të ketë një pajtim trepalësh. Pastaj

pason një analizë e detajuar për mënyrat dhe gjasat e pagesës se si mund të realizohet pagesa e borxheve. E dyta, tek ne fare pak flitet dhe mungojnë informacione për faktoringun si mënyrë alternative e financimit të biznesit dhe e treta, kompanitë sidomos ato shqiptare edhe hezitojnë dhe nuk kanë besim të përdorin faktoringun në biznes", thekson Iseni.

Sipas tij në rajon ekzistojnë edhe shembuj të suksesshëm të përdorimit të faktoringut si mënyrë që shkurton afatet e pagesës së borxheve ndërmjet palëve të ndryshme në biznes.

"Factoringu është treguar shumë i suksesshëm në Kosovë në veprimtarinë e bujqësisë tek bujqit individual që kanë marrëveshje me grumbulluesit apo supermarketet dhe nuk presin për pagesën e mundit të tyre me muaj të tëra apo edhe më gjatë, por menjëherë pas dorëzimit të prodhimeve i fitojnë të hollat", thekson më tej Iseni.

NË PROMOVIMIN E FAKTORINGUT NË MAQEDONI ËSHTË KYÇUR EDHE USAID-I

Nga ana tjetër, ekonomistët thonë se në kushtet aktuale të ekonomisë, të karak-

terizuara nga kufizimet e kredisë për bizneset e bëjnë faktoringun një nga zgjidhjet më favorizuese për kompanitë. Kjo metodë financimi është një nga mënyrat që kërkon një kohë të shkurtër negociatash dhe një nga metodat më të lehta për të siguruar fonde për kapitalin punues, që është një nga pikat më të ndjeshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në ndërkohë, në promovimin dhe mbështetjen e faktoringut në Maqedoni është kyçur edhe USAIDI amerikan.

Sipas Jove Ristevski nga USAID, faktoringu ndihmon në përmirësimin e të hollave për qarkullim për firmat në momentet kur ato më së shumti kanë nevojë për kesh, ndërsa në parim ai paraqet marrjen e borxheve të pa papaguara.

Factoringun në Maqedoni aktualisht e përdorin dhe disa firma, ndërsa si prodhim vite me radhë e ofron edhe Banka e Maqedonisë për Përkrahje të Zhvillimit dhe disa kompani sigurimi.

Në Bashkimin Evropian me një ekonomi të zhvilluar, faktoringu paraqet dhjetë për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndërsa në Slloveni ai ka vlerën prej afër një miliardë euro.

Ndryshe, kriza financiare botërore tregoi më së miri arsyen e zhvillimit të industrisë së faktoringut, pasi shumë banka, pavarësisht se i kishin të siguruar kreditë e tyre me garanci apo kolateral, u gjenden para vështirësive të mungesës së parave kesh apo likuiditetit. Andaj një nga manovrat e Qeverisë Amerikane për të shpëtuar bankat dhe sistemin bankar ishte blerja e llogarive të arkëtueshme të bankave, duke u mundësuar atyre likuiditet të mjaftueshëm për të vazhduar veprimet operacionale.

GRIGORIS TASIOS
PËR MIA-n

Bisedimet për emrin nuk ndikojnë në turizmin midis dy vendeve



Athinë, 9 prill - Bisedimet për emrin dhe lëvizjen në negociatat midis Shkupit dhe Athinës nuk ndikojnë në turizmin dhe valën turistike nga Maqedonia drejt Greqisë, kështu vlerëson Grigoris Tasios, kryetar i Federatës greke të hotelierëve dhe kryetar i Lidhjes së hotelierëve nga Halkidiki. "Mendoj se është shumë e qartë, me vite mbrapa se politika nuk ka kurrfarë lidhje me turizmin, nuk ndikon negativisht në valët turistike nga Greqia drejt Shkupit. Presim edhe ne të shohim si do të jetë rezultati në negociatat midis qeverive, midis qeverisë së vendit tonë dhe Qeverisë së Shkupit", komenton Tasios, derisa në pyetjen nëse marrëveshja eventuale do të ndikojë pozitivisht në turizëm, thotë se marrëdhëniet tregtare janë të mira dhe njëra nuk lidhet me tjetrin dhe kështu ai personalisht nuk pret ndryshime të veçanta pas zgjidhjes së arritur.

Në një bisedë me korrespondentën e MIA-s nga Athina, kryetari i Federatës greke të hotelierëve dhe kryetar i Lidhjes së hotelierëve nga Halkidiki i analizon marrëdhëniet turistike midis dy vendeve, por i transmeton edhe pritjet për vizitueshmërinë e Halkidikit për Pashkët, një majin, por edhe në sezonin veror. "Për shkak të asaj që këtë vit, festa e Pashkëve është shumë herët, nuk ka kurrfarë lidhje me vjet. Të hapura janë vetëm 10-15 hotele. Realizimi është 80 për qind, vizitorët janë kryesisht nga Ballkani, por shumica nga Rumania dhe Bullgaria dhe shumë pak nga Shkup, sepse është herët. Turistët nga Bullgaria dhe Rumania, mesatarisht qëndrojnë 3-4 ditë, ndërsa nga tregu grek qëndrojnë mesatarisht deri në dy ditë. Në lidhje me çmimet, ato janë të njëjta si vjet, nuk ka ndryshime", sqaron Tasios.

Ai thotë se ekziston lëvizje tek turistët nga Ballkani për një maj, por vëmendja e punonjësve turistikë në Greqi është orientuar drejt sezonit të verës. "Vera me siguri do të jetë si në vitin 2017. Presim të ketë rritje të numrit të turistëve në Greqinë jugore dhe në Kretë. Do të shohim. Sezoni fillon në fund të prillit, ndërsa në disa rajone nga 15 prilli. Ajo që na intereson është të mund të kemi më shumë ditë pune. Jemi optimistë se do të jetë një sezon i mirë", sqaron Grigoris Tasios në një bisedë për MIA-n.

FAKTORINGU KËRKON NJË PAJTIM TREPALËSH

"Factoringu në praktikë kërkon një marrëveshje trepalëshe ndërmjet bizneseve dhe institucionit përkatës që të jetë i suksesshëm dhe më vonë nuk ka mundësi që kërkesat financiare të barten tek palat e tretë. Pra nevojitet që të ketë një pajtim trepalësh. Pastaj pason një analizë e detajuar për mënyrat dhe gjasat e pagesës se si mund të realizohet pagesa e borxheve. E dyta, tek ne fare pak flitet dhe mungojnë informacione për faktoringun si mënyrë alternative e financimit të biznesit dhe e treta, kompanitë sidomos ato shqiptare edhe hezitojnë dhe nuk kanë besim të përdorin faktoringun në biznes", Drilon Iseni, drejtor i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimor



KRONIKË

Rreh
nënën dhe
kërcënon
me bombë
policinë

Gjatë vikendit, në Stacionin Policor në Gallate, H.A 45 vjeçare nga fshati Senakos ka denoncuar se është sulmuar nga djali i saj A.A 21 vjeçar. Nga ana e policisë është dalë në terren dhe në oborrin e shtëpisë janë takuar nëna, babai dhe duke biseduar me një person me iniciale N.I për rastin në fjalë. Më pas, djali ka filluar të ofendojë pjesëtarët e policisë dhe prindërit e tij, ndërsa në një moment ka gjuajtur me gurë në drejtim të tyre. Policia e ka paralajmëruar, ndërsa i njëjti është kërcënuar se do të gjuajë edhe me bombë. Më pas policia ka arritur ta arrestojë, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Rrahje në
Bogovinë

Në Stacionin Policor në Kamjan, 61 vjeçari me iniciale K.M nga fshati Bogovinë ka denoncuar se në shtëpinë e tij ka ardhur një person i panjohur. Kur ka dalur jashtë, personi i panjohur e ka pyetur se pse e ka goditur veturën e dhëndrit të tij dhe me pistoletë e ka goditur në pjesën e parme të buzës. 61 vjeçari është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës dhe pas marrjes së ndihmës së parë, është dërguar në Klinikat e Shkupit. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Të shtëna
me armë
në Saraqinë

Në Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë është denoncuar prishje e rendit dhe qetësisë me të shtëna nga armë zjarri në fshatin Saraqinë. Nga ana e policisë është dalur në terren dhe është konstatuar se në shtëpinë e 24 vjeçarit Z.T, gjatë një ahengu familjar është shtënë me një pistoletë gazi të tipit Ecol, të cilin e ka poseduar pa leje. Gjatë kontrollit janë gjetur dhe marrë tetë gëzhojë të plumbit 9 milimetër. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

VËRSHIMET MUND TË PËRSËRITEN



POROJI SËRISH NË RREZIK

Banorët shprehen se premtimet e dhëna kanë ngelur vetëm në letër, derisa kryetari i Bashkësisë Lokale të këtij fshati, Sulejman Ramadani, shprehet se ekziston rrezik për vërshime, sepse pas herës së dytë që kishte vërshime, shtrati i lumit nuk është pastruar

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 9 prill - Reshjet e ardhshme të shiut kurdo që të jenë, do të shkaktojnë problem sërish në Lumin e fshatit Poroj. Niveli i lumit me prurjet e reja të dheut dhe rërës pothuajse ka barazuar lumin me urën. Nëse në afat sa më të shkurtër nuk merren masa, atëherë rreziku është i madh që sërish të përsëriten vërshimet në këtë fshat, thotë kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Poroj, Sulejman Ramadani.

"Sërish i njëjti problem, siç vërehet, me prurjet nga reshjet e shiut dhe nga shkrija e borës, ura është gati të bllokohet e gjitha. Tash presim kush do të merr masa për pastrimin e shtratit të Lumit, sepse shtrati nuk është vetëm tek ura, edhe pjesa e poshtme është mbushur tërësisht me prurje dhe duhet njëherë pastrimi komplet i shtratit lumit", deklaroi ai. Banorët përmes Bashkësisë Lokale kërkojnë që kryeministri Zoran Zaev të mbajë premtimet e dhëna gjatë vitit të kaluar kur kishte patur vërshime të mëdha në këtë fshat.

"Ne mendojmë që për këtë rast të shkojmë të alarmojmë institucionet dhe të shohim se çka do të na thonë për pastrimin që të mos vijë deri tek bllokimi i rrugës. Nuk kemi asnjë informatë nga qeveria, konkretisht nga kryeministri Zoran Zaev, se ai na premtoi se këtë vit do të fillohet me punë, tash jemi në muajin e katërt dhe nuk është marrë asnjë masë. Këtu nuk është vetëm sanimi për një moment. Duhet të punohet seriozisht dhe të mos na përsëriten situatat sikurse

viteve të kaluara", tha Ramadani. Në të kundërtën, banorët nuk përjashtojnë masa më radikale siç janë protestat dhe bllokimi i rrugës Tetovë-Jazhincë në këtë fshat. Banorët shprehen se premtimet e dhëna kanë ngelur vetëm në letër, derisa kryetari i Bashkësisë Lokale të këtij fshati, Sulejman Ramadani, shprehet se ekziston rrezik për vërshime, sepse pas herës së dytë që kishte vërshime, shtrati i lumit nuk është pastruar. "Mbrëmë kemi patur mbledhje dhe diskutuam dhe të marrim informata se deri ku janë punët për këtë problem. Kemi presione nga banorët që të dalim dhe të protestojmë me bllokim të rrugës Tetovë-Jazhincë, sepse nëse vazhdohet me këtë neglizhencë, atëherë do të kemi problem serioze shumë shpejt, sidomos tash kur do të fillojë edhe shkrija më e madhe e borës në bjeshkë", sqaroi Ramadani. Ai thotë se në atë kohë kanë marrë shumë premtime. "Atëherë na premtuan se do të rregullojnë në tërësi shtratin e lumit në fshat, ndërsa në pjesën lartë - sipër fshatit, në shtratin e lumit

premtuan se do të ndërtojnë diga për parandalimin e ndonjë katastrofe edhe më të madhe që mund të ndodh. Ne si Bashkësi Lokale ndaluan banorët e fshatit që të mos protestojnë me arsyen se kemi marrë premtime se këtë vit do të fillohet me punë", nënvizon ai. Zanafilla e vërshimeve në Lumin e Porojit është në bjeshkët mbi fshatin Gjermë të Tetovës. Banorët e fshatit Gjermë shprehën se problemi i vërshimeve në fshatin e tyre dhe më pas edhe në Poroj, është në lumin që kalon në këtë fshat. Burimi i tërë këtij rreziku është në lumin e quajtur "Uji i Shpejtë", prej nga uji bart me vete gjithçka që i del përpara dhe i sjell poshtë në fshatin Poroj. Në kohën e ish-Jugosllavisë janë ndërtuar diga dhe kaskada. Mirëpo, të njëjtat pas vërshimeve të vitit 2015 dhe vërshimeve të mëhershme janë dëmtuar tërësisht dhe pikërisht kaskadat e fundit që parandaluan më të keqen - para një jave janë dëmtuar. Tash edhe banorët e fshatit Xhermë, por edhe të fshatit Poroj janë lënë në mëshirë të fatit.

Zbulohet laborator droge në Gërçec të Shkupit

Shkup, 9 prill - Në fshatin Gërçec të Shkupit, Sektori për Luftimin e krimin të organizuar pranë MPB-së ka zbuluar një laborator për përpunimin e njërës prej substancave më të rrezikshme narkotike në botë. Bastisja, siç njoftojnë nga MPB, është realizuar në fillim të muajit prill, në shtëpinë e të dyshuarit B.M, me çka i njëjti nuk është gjetur në vendin e ngjarjes. Kësisoj, policia e Shkupit deri te Prokuroria e Shkupit, ka dorëzuar kallëzime penale kundër dy personave, gjegjësisht personi B.M dhe O.K nga Republika e Çekisë (i arrestuar). Ndaj të dyshuarve, në pajtim me Kodin Penal, sipas njoftimit të MPB-së, është parashtruar padi penale për "prodhim dhe shitje të jashtëligjshme të lëndëve dhe substancave narkotike". "Gjatë bastisjes së shtë-



pisë së të dyshuarit të parë, i cili për momentin është i pakapshëm për organet e rendit, janë zbuluar më shumë lloje të substancave kimike të cilët kanë qenë të ruajtur në shishe dhe sende të ndryshme. Pas ekspertizës së kryer është vërtetuar se bëhet fjalë për metamfenamin, benzil metil keton dhe pseudoefedrin, si dhe substanca tjera për

prodhimin e drogës sintetike. Metamfenaminin është substancë psikotrope, përderisa benzil metil keton dhe pseudoefedrin paraqesin lidhje për fitimin e substancave psikotrope. Ndryshe, këto substanca kimike shfrytëzohen për prodhimin e njërës prej drogave sintetike më të rrezikshme në botë, të cilët njihen me emrat 'kristal

met', 'pernik' apo 'perventin'. Ky lloj i drogës për herë të parë zbulohet në Maqedoni, ndërsa më tepër prodhohet në Republikën Çeke. Me shfrytëzimin e saj shkatërrohet sistemi nervor dhe truri. Pas dy viteve të përdorimit të kësaj droge, mund të shkaktohet vdekja", thuhet në njoftimin e MPB-së. Ndryshe, nga policia theksojnë se të dyshuarit B.M dhe O.K, gjatë muajit mars të këtij viti në mënyrë të jashtëligjshme janë furnizuar me material dhe substanca për prodhimin e drogës sintetike, respektivisht bashkërisht i kanë instaluar pajisjet në shtëpinë e B.M dhe kështu kanë filluar me procesin e prodhimit të drogës në fjalë. Gjykatësi në procedurë paraprake të dyshuarit O.K, i ka caktuar masën e paraburgimit 30 ditore. (O.Xh)

PROJEKTI MALMO-PALERMO EXPRESS

Dy projekte gjigante në fushën e inxhinierisë do të ndryshojnë peizazhin europian. Ato do të ndikojnë në përmirësimin e transportit ndërmjet veriut dhe jugut të Europës. Kur ra Muri i Berlinit, Europa filloi riparimin e infrastrukturës së transportit të rrjeteve të saj të prishura ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Rindërtimi i një linje hekurudhore ndërmjet Parisit dhe Moskës ishte fillimi i një epoke të re, shkruan The Economist.

Thelbi i kësaj strategjie është "Korridorit skandinavo-mesdhetar" nga Suedia dhe Finlanda, përmes Danimarkës, Gjermanisë, Austrisë në Itali dhe Maltë në jug. Ky program, i financuar bashkërisht nga BE-ja dhe shtetet anëtare, përfshin elektrizimin hekurudhor, modernizimin e porteve dhe dy prej projekteve më të mëdha inxhinierike në kontinent.

Por, pse është i nevojshëm një investim i tillë? Me anë të linjave të tyre të ndërlidhura të transportit me anije dhe me anë të zinxhirëve të furnizimit industrial, Kopenhaga dhe Hamburgu janë tashmë një ekonomi e vetme në shumë drejtime. Por kalimi nga njëra tek tjetra është shumë i vështirë. Rruga nëpërmjet tokës, në të cilën kalojnë qindra kamionë në ditë, zgjat rreth gjashtë orë. Ekziston edhe një formë tjetër transporti, ai detar, por edhe ky është gjithashtu shumë i lodhshëm. Pas një rrugëtimi të shkurtër nga Kopenhaga në bregun

jugor të Danimarkës, treni e ul shpejtësinë teksa hyn në portin e Rodby-it. Edhe pse në binarë të veçantë, ai hyn në një traget pranë makinave dhe kamionëve të tjerë. Pasagjerët zbresin dhe nxitohen për të shkuar në dyqanin e vetëm në bord (ku alkooli dhe cigaret mund të shiten vetëm në ujërat gjermane).

Pas një ore, trageti ankorohet në Portin e Puttgardenit, ndërsa pasagjerët kthehen në tren, i cili e rrit shpejtësinë në drejtim të Hamburgut. I gjithë udhëtimi mes dy qyteteve zgjat 4 orë dhe 33 minuta. Për projektin e Fehmarnbeltit ranë dakord si qeveria gjermane ashtu edhe ajo daneze në vitin 2007, dhe më vonë, në 2015, ai u miratua nga autoritetet daneze të planifikimit. Tani mbetet vetëm në dorë të planifikuesve gjermanë që ta miratojnë atë deri në 2020, periudhë në të cilën duhet të fillojnë edhe punimet. Pavarësisht protestave, planifikuesit janë të bindur se do të arrijnë të marrin leje deri vitin e ardhshëm. Financuar nga qeveria daneze, e cila do të kompensojë paratë e saj nga mbledhja e taksave, ndërtimi do të përfshijë uljen e pjesëve të mëdha të njësive të tunelit në nivelin e detit, i njohur si "Parimi i Lego", sipas z. Cornett.

Kur të përfundojë në vitin 2028, ky do të jetë tuneli më i gjatë nënujor në botë. Me përmirësimin e rrugëve dhe hekurudhave, ai do të shkurtojë kohën e udhëtimit me

tren nga Hamburgu në Kopenhagën në 2 orë dhe 40 minuta. Ndërtuesit parashikojnë që trafiku rrugor përgjatë ngushticës në vitin 2030 të jetë më shumë se dyfishi i asaj që ishte në vitin 2011.

Udhëtimi nga Hamburgu në jug të Gjermanisë është bërë më i lehtë nëpërmjet autostradave dhe trenave me shpejtësi të lartë. Këtu mund të përmendim përmirësimin e linjave hekurudhore nga Saksonia apo Bavaria në jug të Gjermanisë. Gjatë dhjetorit të vitit të kaluar, Kancelarja gjermane, Angela Merkel, iu bashku një grupi të përbërë nga personalitete të shumta, në një udhëtim me tren nga kryeqyteti gjerman në Mynih, që zgjati katër orë, në krahasim me gjashtë orë më përpara.

Pastaj, udhëtimi ngadalësohet në mënyrë drastike. Nga Insbruku në Austri, treni zvarritet deri në kalimin e Brennit, si pasojë e terrenit të vështirë malor, duke i krijuar mundësinë pasagjerëve që të sodisin edhe detajet më të vogla të natyrës përçark.

Vetëm dy orë pasi është larguar nga Insbruku, kur arrin në Fortezza të Italisë, treni nis ta rrisë shpejtësinë. Por as zgjedhja e përshkimit të këtij segmenti nëpërmjet rrugës automobilistike nuk është një më e mira, sepse në vit në këtë rrugë udhëtojnë rreth 1 milion kamionë, duke e bllokuar shpeshherë trafikun dhe duke krijuar radhë gjigante makinash.

Për këtë arsye, tuneli i Brennerit, 40% i financuar nga BE dhe pjesa tjetër nga qeveritë austriake dhe italiane, rreth 64 km nga Insbruku deri në Fortezza do të jenë më i gjati në botë kur të hapet në vitin 2026. Ai mund të ndikojë fuqishëm edhe në transformimin dhe rritjen e tregtisë ndërmjet këtyre vendeve europiane, duke e rritur numrin e trenave që kalojnë në ditë, nga 240 në 591, të cilët kryesisht do të transportojnë mallra.

Që nga viti 2009, trenat Frecciarossa dhe Frecciargento (me shigjeta të kuqe dhe argjendi) kanë shkurtuar kohën e udhëtimit Milano-Napoli, nga tetë orë në pak më shumë se katër orë. Por nga Napoli, investimet u ndalën. Ka një shërbim të ngadalshëm dy herë në ditë në Sicili me një traget nga Salerno dhe një në ditë nga Villa San Giovanni. Kontrasti me veriun e Europës është shumë i theksuar: ngushtica e Messinës ka pothuajse sa gjysmën e gjerësisë të urës së Oresundit, dhe pikërisht ndërtimi i një ure për Sicilinë ka qenë edhe një prej pengjeve më të mëdha të politikanëve për dekada të tëra. Ishulli vazhdon të mbetet financiarisht i varfër për të qenë në gjendje që të përballojë një infrastrukturë të tillë, me trena me shpejtësi të lartë për në Palermo.

Ky është një shembull i mirë për politikanët europianë, të cilët poshqetësohen në lidhje me një ndarje të re ndërmjet Lindjes dhe Perëndi-



mit. Dhe kjo përçarje ka të bëjë sigurisht me politikën, por përçarja veri-jug e kontinentit shkon edhe përtej politikës, duke përfshirë barrierat e papërshtatshme si malet e larta dhe detet e thella, si dhe dallimet e shumta kulturore dhe ekonomike. Në mënyrën e vet, projekti Malmo-Palermo do të ishte një arritje e madhe politike, po në të njëjtin nivel si dhe ai Paris-Moskë, shkruan The Economist.



Shqipëri, 2.6 miliardë euro jashtë sistemit bankar

Sasia e parave që qarkullojnë jashtë sistemit bankar në Shqipëri kap vlerën e 2.6 miliardë eurove. Një analizë e Fondit Monetar Ndërkombëtar thotë se kjo vlerë është sa 17 % e prodhimit të brendshëm kombëtar. "Një ekonomi me informalitet të lartë, ku sipas disa vlerësimeve është në nivelin 40% të GDP, mbështet preferencën e popullsisë për të mbajtur Cash, para jashtë sistemit bankar," thotë studimi. FMN shprehet se nga viti në vit tendenca është shfaqur në rënie, duke marrë shkasë edhe nga formalizimi i ekonomisë, por ky trend është ndalur menjëherë në vitin 2014-ë, kohë që përkon me uljen në nivele historike të normës bazë të intere-

sit. Informaliteti që në këtë rast llogaritet në 40% të GDP-së nuk specifikohet ku është i përqëndruar, për të kuptuar se nga gjenerohen këto para. Ky fenomen, siç shpjegon më lartë FMN, gjeti zgjerim nga viti 2014 e tutje, një periudhë që lidhet me mbjelljen dhe trafikimin e sasive të mëdha të kanabisit, para të cilat mund të jenë injektuar në ekonomi përmes rrugëve informale. Megjithatë vetë qeveria nuk ka bërë asnjëherë një vlerësim të ndikimit të ekonomisë së kanabisit në ekonominë e vendit. Sipas FMN, Shqipëria mban vendin e parë mes 10 ekonomive të Ballkanit për qarkullimin më të lartë të parasë jashtë sistemit bankar.

BE jep 932 milionë euro për gazjellësin TransAnatolian

Banka Europian e Investimeve miratoi në datën 15 mars kredinë prej 932 milionë eurosh për ndërtimin e gazjellësit TransAnatolian (TANAP) që përbën seksionin turk të Korridorit Jugor të Gazit. Ky i fundit është projekti më i madh energjetik ku është përfshirë BE-ja dhe përmes tij synohet kalimi i 16 miliardë metra lub gaz në vit që kanë si burim Azerbajxhanin. TANAP do të kalojë përmes Gjeorgjisë, Turqisë për të përfunduar në kufi me Greqinë ku lidhet me gazjellësin TransAdriatik.

Grupime të ndryshme kanë kundërshtuar projektin duke argumentuar se ai dëmton mjedisin, bie ndesh me angazhimet e BE-së qoftë në këtë drejtim, qoftë edhe për të drejtat e njeriut.

Sipas një studimi të realizuar nga Bankwatch, emetimi i metanit dhe djegia e gazit në këtë sektor krahasohet me ndotësin më të madh që është qymyri.

Të njëjta grupime thonë se BE-ja po bën sikur nuk shikon se çfarë po ndodh me nënkontrakt-



torët e projektit në Turqi. Sipas tyre të gjithë subjektet në fjalë janë rekrutuar nga kompania shtetërore Botas, që ka lidhje direkte me presidentin Erdogan. E njëjta skemë vepron edhe në Azerbajxhan dhe ngjan disi e çuditshme që BE-ja akordon rreth 1 miliardë euro në përfitim të rrethit dhe pushtetit të dy njerzve që përndryshe i konsideron si shkelës të drejtash: Erdogan dhe Aliyev.

Në këtë kuadër, në dhjetor të vitit të shkuar, 33 anëtarë të Parla-

mentit Europian i kërkuan Bankës Europiane për Investim të mos financojë projektin TANAP por duket se kërkesa nuk është marrë parasysh. Në total BE-ja ka investuar në projekt më shumë sesa 6 miliardë euro.

Ky projekt është miratuar pa një vlerësim paraprak klimaterik dhe në kundërshtim me kërkesat e Marrëveshjes së Parisit për mbajtjen e temperaturës globale poshtë rritjes me 2 gradë Celcius, shprehet ndër të tjera, Anna Roggenbuck nga Bankwatch

DHUNË!

Nga

Adelina MARKU



Sigurisht që edhe ti lexis i/e nderum/e do dakordohesh me gjykimin tim se partitë politike shqiptare në Maqedoni nuk i ngajnë vetes më. Ajo çka nuk mundem më të lexoj tek to është ideja, freskia, inovacioni, inisiativa, modernizmi, hapja...takimi e prekja empatike me votuesin! Ajo çka unë vazhdimisht shoh në to është një garë për poste brendapartiake! Copa u banë, thu ti i ka pjell nana kryetar degësh (vaaap! Ha kryetar dege, mashallah! Nesër garant ministër, drejtor...), e haberin nuk ia kanë lidhshpirtit, njerzillëkut, kulturës esnafa për tjetrin me e vlerësu mjaftushëm e me ndihmu tansinë! Ndojnani nga to edhe hoxhë biles. Gjykojnë: ka mexhllis, sjell votë! Edhe hoxhë edhe kryetar dege! Ke pa ti kështu!? Has në shkrimet statusesh e programesh partiake identike, një pompozitet tip tejshtesë për zgjedhje të reja dhe megallomani për hov të tipit: "mule se do fitoj", hyrje-dalje nga kualicionet e përsëri një grumbullim me popullin për me sqaru fillimisht pse hyjn e mbasandej pse dalin nga qeveria, nga një preskonferencë tek tuk, me lexime telegrafike kumtesash ose me emocionalizma që shkaktojnë qimengritje hë për hë. Ditët, vitet e dekadat ikin e rreshten në harresë, katundet shprazen, toka mbetet e papunuar, qyteteve iu ndërrohen demografitë nga hakarretja e ikjes së shqiptarëve nga vendet e trashëgume me shekuj, ...votues sa vjen e më pak ndërsa parti shqiptare sa vjen e më shumë! E gjitha kjo llakërdi është si pasojë e ikjes nga vetja! E çka është kjo, po hamendesh ti?

Me ik nga vetja është me ik nga mbrothia!

Aq të shpeshta janë bërë këto ngarrendje brendapartish sa që interesimi për angazhim partiak ka rrenë në nivel akutisht të rëndomtë për një njeri që njimend e ka me ndihmu tjetrin...sepse, parë esnafisht, partitë bahen për me i ndihmu idesë dhe njeriut me u mëkëmbë! Po po, nuk e kishe ditur ti se përsë bëhen partitë!? T'a sqarova, është e thjeshtë, bahen me ndihmu idesë e njeriut që i sfidon kohës me kreativitet por edhe atij që nuk ia ka nxan fati i mirë në jetë! Në parti njeriu anëtarësohet me i ndihmu të mirës së përgjithshme pa dallim, me i kriju asaj

rrjetëzim dhe armaturë më të hekurt, me solidarizu intelektualizmën që përmban me atë të tjetrit, me u ndërvarë bindshëm n'komunikim të brendshëm, me BESU, me ndigu halle e derte e me gjet mënyrë qysh me i ndreqë punët e hakarretuna mbrapsht. ...Partitë bëhen për me drejtu institucionet e shtetit e mbasnej për me kriju tjera e ma të mira, bahen për me i shtu ide ekonomisë për ma mirë e me hap vende të reja pune konkurrenente jo parazitësh, bahen për me dhan kontribut në shoqni, për me i ndihmu fëmijëve me kuptu demokracinë si proces e jo si gjellë t'gatume, për me ja mësu mësimin se trimi i mirë bën me shokë shumë e se autoritetin e Prisjit t'a bëjnë të mirët e jo qyrravecët, poltronët e rrugaçët, kriminogjenët! Dhe kjo letargji partiake, sindromi konformist po e quaj, përsëritet në cikle e në vazhdimësi e për më keq, cilësia e njerëzve që udhëheqin strukturat partiake është pothuajse e paidejshme, aspak frymëzuse, anemike, për më shumë është e tillë që autoritetin e gëzon përmes asaj se sa frikë e intrigë mund të fusë damarëve degëve të partisë! Thu ti janë krejt Rambo dhe Rasputina!

Nevoja për të shndëruar dhunën në garrë për lidhshpirt flet se këta djem (e vajza shumë rrallë, ose aspak! Kryetare dege partish nuk ka ndër parti shqiptare! E kuptove?) o kanë përjetuar trauma të rrënda në jetë e nuk i kanë tejkaluar, o janë shpërthyer në fuqi traume të re e testosteronike vetëm kur ia ka mshu shpine lideri, Ai i Madhi, tuj i than: "Je ma i miri, i ke tut i ke myt! – për me shtu mbasandejta pata pas thanë, shqiptari veç tutën e njej!"....

(Me hesap del se ky Lideri i Madh është Mbret i Friknxitësve e jo i lirishtësve libertarian!)

"Hihihihiiiiii"- një zgërdhimje e jep mbasnej, e tjerët thu ti shlirohen nga zgërdhirja e Liderit të Madh! Huxhum, zgërdhihen rrend edhe ata, si orkestër!

Në të dyja variantet e traumave, ekuacioni tregon për primitivizëm dhe organizime inerte, madje aq inerte sa mobilizim grryejnë vetëm nëpër cikle zgjedhore! E në kanë mbetur në këtë nivel partitë tona shqiptare, nuk di se çka mund të presim prej tyre më?! Ose, prandaj s'presim gjë prej tyre ma! Doemos që lajmi mbi kacafytjen n'parti të tipit

"kush'i'pari'bani" i paradoditëve, mes burrave që u vranë e u therrën ishte lajm tronditës! Pyetja ime e parë ishte: a kanë lanë fëmijë pas? E dyta, ç'të vërtetë i kanë thanë fëmijës për babën e vranë!? Traumë familjare! Mort!

E vërteta flet se votuesi shqiptar paraqet një numër madhor që kryesisht meret me tokën e me agrikulturën, kurbetin! Vonë i kyçun në institucione! Në esencë, njeriu që punon tokën pritet që nga ajo të thith paqën dhe dëshirën për të kriju mbarësi e pjellni ma të madhe për familjen! Për më shumë, njeriu që rrit veten përmes tokës, në esencë është bujar dhe me durim rreptësisht të dukshëm e deri në spikamë! Stërgjyshërit e mij kanë begatuar veten përmes kësaj ndjesie e bujarie e tuj vizionu për fëmijët, kanë pas për qëllim majat intelektuale për ta. Sado nga prespektiva e bujkut, ata kanë shkolluar fëmijët e tyre dhe kanë ndriçuar rrethin me mendjeartët e gjeneratave të reja! Kështu kanë liberalizuar rrethin dhe atdheun, ngadal' ngadal', si fara e mbjellun me kujdes e përrulje Diellit! Besa, nuk është DHUNË e syrgjynosje të

mbroresh nga një sistem diskriminues që ka për synim të të rrjepë këto cilësi fisnike (shqiptari është mbrojtur tek ia kanë dhunuar fisnikërinë!), DHUNË e vetësyrgjynim është kjo e sodit kur i riu/e reja tenton të ikë nga kjo origjinë e kujtesë e trashëguar nga të parët e të synojë qëllim për të cilin nuk din t'a lexojë mjaftueshëm! Të lexosh thellësisht lidhshpirtin dhe garën, është njësoj sikur të mbjellësh farën në tokë e të miklosh rritjen e saj! E për këtë nevojitet durim, respekt dhe maturi. Më vonë e pas shumë vitesh, kur njeriu prek mençurinë thellë në vete, edhe mund të garojë për të udhëhequr. Në të kundërtën, çdo gjë është dhunë, intrigë, komplot, relativizim, nihilizëm, papërgjegjësi, kapadaillek, kapërcim dhe prandaj - gjak!

(Mos pyet më gjatë, ndodhi gjaku në Reçicë t'Tetovës para ditëve! Mbulojë me dhe, hesht, mbaje turpin, fut bishtin ndër kamb dhe mëso mësimin! Ti lexues/e i/e nderum/e, mos u turpno për çka ndodhi, përkundrazi thuj vetit: sa mirë që s'jam me ta! Zgjodha ndrysh!)

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 9 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

A DO TË KETË PAZAR, LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE PËR AMNISTINË?



Nga
Rizvan SULEJMANI

Kaluar ditë përplot me dramë në procesin e miratimit të ligjit për përdorim të gjuhëve, por epiloz final ende nuk ka. Që ligji të hyjë në fuqi duhet të shpallet në gazetën zyrtare, kurse për te duhet nënshkrimi i dy institucioneve shtetërore kryetarit të shteti dhe kryetarit të parlamentit. Ky i pari sipas kushtetutës tanimë është i obliguar ta nënshkruaj pasi një herë e shfrytëzoi të drejtën për ta kthyer në rishqyrtim dhe sipas procedurës ligji u miratuar me shumicë absolute me 67 vota. Por ja që ai nuk e nënshkruan me arsyetimin se ligji është antikushtetues edhe pse organ për vlerësimin e kushtetutshmërisë është Gjykata Kushtetuese. Kjo shton dilemën nga e merr të drejtën kryetari për këtë veprim anti-kushtetues? Por shumë më me rëndësi cila është arsyeja e vërtetë e mosdekremit të ligjit. Disa jurist thirren në praktikën e deritanishëm pasi ka pas raste kur kryetarët paraprak nuk e kanë nënshkruar ligjet dhe ata nuk kanë hyrë në fuqi.

Pjesa dërmuese e ekspertëve janë të mendimit se kryetari është i obliguar ta bëjë atë përveç partisë VMRO-DPMNE dhe disa ekspert të afërta me te. Çështja shtrohet, është ky veprim politik apo juridik? Gjegjësisht, kush e bllokoi nënshkrimin VMRO-DPMNE apo Ivanovi? Debatit sot zhvillohet në këto dy binarë, por për mua është më me rëndësi pista e tretë që duhet analizuar, kush do të triumfojë, amnistia ndaj krimi dhe korrupsioni apo ligji?

Kam përshtypjen se ligji për përdorimin e gjuhëve shumë më tepër bëhet pazar me amnistinë për krim dhe korrupsion që rrezikon stabilitetin dhe ardhmëria sesa për parime. Këtë qëndrim nuk e kamë prej sot. Në një emision televiziv me rastin e amnistisë që u bëri Ivanovi, Gruevskit dhe njerëzve të tij me qëllim deblokimin e procesit politik, që rrezikonte ta nxjerrë shtetin jashtë kontrollit, unë kisha thënë: "do të jetë shumë keq nëse dikush nuk do të dënohet, por kamë frikë se epilozu i fundit do të jetë, amnistia, qoftë direkte, apo indirekte, e heshtur apo transparente". Arsyetimi kryesorë atëherë ishte, që edhe sot qëndron; Maqedonia nuk ka kapacitet të luftojë krim prej pesë miliardë euro saç parashihej atëherë, bile as për pesëqind milion euro. Ajo

më parë do të destabilizohet sesa do ta fitojë këtë luftë. Si argument kisha përdorë dhe qëndroj pas saj dy çështje; një, se Maqedonia është shtet multietnik dhe gjithmonë kur aktualizohet lufta kundër krimi dhe korrupsionit nxiten problemet ndëretnike deri në vlim, saqë komplet e vendos opinionin publik. Marrëdhëniet ndëretnike janë ata që "rrezikojnë" stabilitetin e shtetit, andej kur duhet të zgjidhet ndërmjet stabilitetit dhe drejtësisë, kjo e para triumfon. Në mbështetje të këtij qëndrimi përmenda përvojat e para vitit 2002 pas konfliktit dhe gjatë viteve 2002-2006, kur qeveria e atëherëshme bëri disa përpjekje që ta ndjek krimin e qeveris së Libço Georgievskit, bile edhe vetë atë.

Dua të përkujtoj se në atë kohë ndodhi një vrasje misterioze të shtatë emigrantëve nga Pakistani dhe India, diku afër Liqenit të Smillkovës, që u quajtën terrorist në mbështetje të "terroristëve shqiptarë". Kjo ngjarje menjëherë pas përfundimit të luftës së 2001-it krijoi një shok serioz në opinion. Faktori ndërkombëtarë që ende ishte prezent edhe në teren edhe në institucionet e sigurisë shpejtë i demantoi dhe doli se disa prej të dyshuarve ishin ose të shërbimit sekret ose të njësitit të atëherëshëm special.

Pas formimit të qeverisë dhe stabilizimit politik, u paraburgosën disa ish drejtorë të ndërmarrjeve publike bile edhe ministri, kurse kryeministri i atëherëshëm Hari Kosotov doli në parlament me një kasetë, me të cilën e kërcënonte Lubço Georgievskin. I shtrënguar nga faktori ndërkombëtarë në këso rrethana Lubço Georgievski po sikur Gruevski tani, partinë ia dorëzoi njeriut të tij të besuar Gruevskit që ta ketë si mbështetje. Siç rritje presioni dhe ngushtojë rrethi erdhi edhe deri tek konflikti ndërmjet këtyre dyve që solli deri tek përçarja e kësaj partie ku një grup deputetësh më i madh vazhdoi të ndjek Georgievskin kurse tjetri Gruevskin.

Fushata e luftës kundër korrupsionit mori një kahe krejt tjetër kur u aprovua Ligji për ndarje territoriale. Disa intelektual po sikur sot që bëjnë me ligjin për përdorimin e gjuhëve filluan atë ta interpretojnë si federalizëm, ndarje e Maqedonisë dhe rrezik për të ardhmen e shtetit.

Organizuan protesta shumë agresive siç ishte rasti me tendencën për ta djeg të gjallë i ministrit të mbrojtjes së asaj kohe, Buçkoski, më pas kryeministër, kur shkoi në Strugë ti bind qytetarët që të pranojnë ligjin. Më pas po të njëjtit intelektual, organizata joqeveritare dhe partitë politike më të vogla ngritën iniciativë për mbledhjen e nënshkrimeve për referendum, që nuk mund ti siguronin. Vetëm pasi Hari Kostovi një bankier i mirë por një kryeministër në detyrë i keq, në një debat televiziv (nga padija) deklaroi se do të vendos në rend dite në parlament iniciativën nëse mblidhen 150.000 nënshkrime gjërat ndryshuan rrënjësisht. Ata e dinë Marrëveshjen e Ohrit e kanë të qartë se ligjet që aprovohen me dy shumica nuk mund ti nënshtrihen referendumi. Por kryeministri në detyrë ose nuk besonte se mund të mblidhen nënshkrimi ose nuk e dinte këtë fakt andej deklaroi se do ti mundësonte parlamentit të bjer vendim për referendum. Luçço Georgievski e pa shansin vendosi makinerinë e tij partiake në lëvizje dhe mblodhi nënshkrimet e nevojshme. Me këtë u arritën dy qëllime; opinionin nga lufta kundër korrupsionit u ç'vëndos në luftë ndëretnike dhe dy, krijoi hapësirë për pazar për lirimin e vetes dhe shokëve. Referendumi nuk pati sukses për më tepër arsye.

Duke filluar nga pranimi i Maqedonisë me emrin kushtetues nga SHBA-ja, tërheqjen e Lubço Georgievskit nga agjitimi tani për të dalë në referendum dhe votuar kundër ligjit, me arsyetim banal se Gruevski që zyrtarisht ishte kryetarë i VMRO-DPMN-së kinse nuk ka dashtë që ky si rival i tij të ishte në binë bashkë me organizatorët tjerë. Por, pas kësaj pasojë një ligj antikushtetues me të cilin u liruan të paraburgosurit për vrasjen e emigrantëve (gjykata kushtetuese e abrogoi atë por ata u liruan dhe sipas ligjit nuk mund të ktheheshin prapë), për të paraburgosurve tjerë u gjetën solucioni lehtësuese dhe pothuajse asnjëri nuk vuajti burg serioz. Për gjithë këto pazare prova nuk ka, por mbetet dyshimi se stabiliteti i shtetit dhe ardhmëria e tij u pazarit për amnistia nga krimi dhe kriminalitetit.

Duket se historia përsëritet. Me fillimin e presionit të faktorit ndërkombëtarë për ndërrimin e

Qeverisë së Gruevskit, patëm më tepër ngjarje që lënë shumë dyshime. Ndodhi një vrasje prapë misterioze për afërsisht në të njëjtin vend tek Liqeni i Smillkovës, ku përsëri u akuzuan si terroristë shqiptarët. Ndodhën bombat që rrezikonin pushtetin e Gruevski, ndodhi Kumanova pas së cilës mbeten shumë paqartësi, kush sa ishte i përzierë në ngjarjen. Pjesa më e madhe e analistëve këtë e panë si punë të shërbimeve sekrete për të tërheq vëmendjen nga bombat e Zaveit që e demaskonin "patriotizmin" e Gruevskit kurse zbardhnin korrupsionin dhe krimin e tij dhe qeverisë.

Erdhi deri tek një polarizim jo shqiptaro-maqedonas por shqiptarët kundër Gruevskit dhe qeverisë së tij, që bëri nga revolta të votojnë Zavein dhe LSDM-n jo nga bindjet ideologjike. Pas shumë përpjekje për formimin e institucioneve, parlamentin, ndodhën edhe ngjarjet e 27 prillit për të ndërprerë formimin e një koalicioni që do ta linte atë jashtë qeverisë. Pas gjithë kësaj ishte e qartë se do të pasojë proces gjyqësorë për keqpërdorime financiare. Pati edhe një përpjekje të Ivanovit për amnistia që u refuzua nga opinionin publik dhe opstrukcione tjera që sipas shumicës së analistëve qëllim ishte ikja nga drejtësia. Kur dukej se koha e Gruevskit mbaron dhe filluan proceset gjyqësore ndodhi Ligji për përdorimin e gjuhëve. Prapë një moment i ngjashëm si vitin 2004 kur u aprovua ligji për ndarjen territoriale. Të njëjtit intelektual me disa të rijë ligjin e kualifikuan si federalizim, prishje e shtetit dhe ndarje të Maqedonisë. Një spin perfekt që e devijoi opinionin publik nga lufta kundër korrupsionit në luftë ndëretnike. Kush-ti kryesorë i VMRO-DPMNE-s për tu kthye në parlament dhe për të marrë pjesë në ligjet reformuese dhe proceset euro-integruese është lirimi i të burgosurve dhe abrogimi i ligjit për gjuhët.

Rastësisht apo jo, ligji ka hy në labirinte juridike, gjegjësisht hyrja në fuqi e tij është ndalu, kurse të paraburgosurit për rastin e 27 prillit u liruan. Fakt është se pesë prej tyre u kthyen sërish në burg por nuk e di si do të zhvilloheshin punët sikur të mos kishin ndodhur dëbimi i diplomatit rus sa në shenjë solidariteti me Mbretërinë Angleze sa për involvim të tij në ngjarjet e 27 prillit

Lufta kundër krimi që rrezikon stabilitetin bëhet pazar me një të drejtë të shqiptarëve. Ma e keqja, nëse kjo ndodhë, do të jetë se drejtësia do të dorëzohet para krimi që përgjithmonë do ta pamundësoj funksionimin e shtetit ligjorë dhe me te edhe ardhmërinë e shtetit. Në këso rrethana mbetet pyetja, a do të bëhet pazar Ligji për përdorimin e gjuhëve me amnistia kundër krimi dhe korrupsionit?



dhe sikur Ivanov haptas të shpallte këtë vendim të qeverisë si të ngutshëm. VMRO-DPMNE në mënyrë perfide luan një lojë të dyfishtë në këtë rast. Me një fjalë shumë ngjashmëri që të shtynë të mendosh nëse në fund ligji për përdorimin e gjuhëve do të jetë pazari i fundit që duhet të mbaroj me një amnistia, direkte, indirekte, të fjetur apo që do ti len në harresë korrupsionin. Gjegjësisht, prapë lufta kundër krimi që rrezikon stabilitetin bëhet pazar me një të drejtë të shqiptarëve. Ma e keqja, nëse kjo ndodhë, do të jetë se drejtësia do të dorëzohet para krimi që përgjithmonë do ta pamundësoj funksionimin e shtetit ligjorë dhe me te edhe ardhmërinë e shtetit. Në këso rrethana mbetet pyetja, a do të bëhet pazar Ligji për përdorimin e gjuhëve me amnistia kundër krimi dhe korrupsionit?



Filmi 'Everybody Knows' do ta hapë Festivalin e Filmit në Kanë

Filmi "Everybody Knows" do të jetë filmi që do ta hapë këtë vit Festivalin e Filmit në Kanë. Penelope Cruz dhe Javier Bardem janë bashkuar për rolet kryesore në film. Filmi me regji nga Asghar Farhadi, në gjuhën spanjolle, me datë 8 maj shfaqet në Kanë, dhe është pjesë e garës për Palmën e Artë.

"Everybody Knows" (Të gjithë e dinë) tregon historinë e Laurës, që largohet nga Buenos Aires për në fshatin e lindjes në Spanjë. Një bashkim familjar do ta sjellë një të kaluar e të haruar që më pas do të bëjë gjërat të ndryshojnë zhvillimin e tyre. Cate Blanchett, aktore e njohur, do të jetë presidente e jurisë së Festivalit. Me datë 12 prill do të bëhet i ditur programi në tërësi i Festivalit të njohur në Francë.

AKTORI SHQIPTAR NË NJË FILM ME STALLONEN E MICHAEL B. JORDAN

Aktori shqiptar Marko Caka, vazhdon të jetë protagonist në filmat e mëdhenj hollivudian, shkruan KultPlus. Kështu, së fundmi kanë nisë xhirimet e filmit të madh të Warner Brothers Creed versioni 2 me protagonist Silvester Stallone e Michael B Jordan. Në këtë film luan edhe shqiptari Caka, ku roli i tij është një nga katër policët e sigurisë në ringun e famshëm të Las Vegas. Në këtë ring, luhen duelet e mëdha të sportit të boksit ku trajner është Silvester Stallone në rolin e Rocky Balboas.

"Ishte hera e parë që luaja në sheshxhirim me Stalonen. Hyrja e tij solli duartrokitje të pa ndërprera dhe duke marr fjalën, falënderojë kastin dhe ekpin e kineastëve dhe gjithë stafin e produksionit. Për mua ishte ëndërr ta kisha pranë gjatë gjitha skenave më shumë se 15 orë. Isha vazhdimisht



pranë stafit të boksierëve në rolin e Dupray, e rojës se sigurisë së legjendës së filmave aksion, i cili ka shkruar historinë të Rocky Balboa's. Absolutisht, që ndjehem i privilegjuar nga kastingu i Warner

Bros, i cili me krijonjë përsëri mundësinë për të përjetuar skenat e mëdha të saj me yjet e kinemasë botërore", pohoi për KultPlus, Marko caka, duke vazhduar të tregoj se tashmë ai është edhe në një

film tjetër të Warner Bros në vazhdimësinë e xhirimeve të filmit epik "Godzilla 2" në Atlanta ku xhirimet i kanë në fund të javës.

Xhirimet e Creed II po zhvillohen në Pennsylvania ku aktorët protagonist do të jenë pothuajse të njëjtit e Creed 1, Silvester Stallone, Michael B Jordan në rolin e bokserit dhe këtë radhë i afrohet kastit edhe Dolph Lungren në rolin e Ivan Drago, por tani në atë të trajnerit të skuadrës kundërshtarë ruse.

Ky film do të shfaqet në kinematë e botës në nëntor të këtij viti dhe pritet të ketë jehonë të madhe sepse do të ketë përsëritje të përballjes së shekullit si në filmin e Rocky IV në mes dy boksierëve që përfaqësonin dy siperfuqitë e mëdha të kohës, por që sot ata janë trajnerë të ekipeve respektive ShBA -Rusi.

Autori gjerman rikthen tek shqiptarët Aleksandër Moisiun

Libri "Aleksandër Moisiu. Trieshtë – Berlin – Nju Jork. Një legjendë aktrimi" nga autori gjerman Rüdiger Schaper është promovuar në Prishtinë. Përmes këtij promovimi të pranishmit patën mundësi që ta njihnin më shumë aktorin por edhe të dëgjonin më shumë nga autori mbi faktet, kritikën dhe dokumentet e tjera të cilat ai i ka mbledhur dhe ndërthurrur në librin e tij, shkruan KultPlus.

Libri i autorit Schaper "Aleksandër Moisiu. Trieshtë – Berlin – Nju Jork. Një legjendë aktrimi" është përkthyer në shqip nga Feride Berisha. Një bashkëpunim në mes Shtë-



pisë Botuese PA dhe Qendrës Multimedia, i përkrahur nga rrjeti Traduki.

Përkthyesja e librit njëherësh edhe drejtoresha e Shtëpisë Botuese "PA", Feride Berisha e ka konsideruar një aksident të bukur këtë përkthim të rëndësishëm për kulturën.

"Libri që ka ardhur sot në gjuhën shqipe është një rastësi me dashje. Librin ma ka dhuruar një mik i imi për kërkëndella. Kur e mora librin, jam befasuar se kush ka qenë Aleksandër Moisiu. Deri tani e kemi mësuar me patriotizëm Aleksandër Moisiun, aktor i madh shqiptar,

mirëpo pikërisht Aleksandër Moisiu ka qenë një aktor i njohur botëror", tregoi ajo për të pranishmit.

Para të pranishmëve autori i librit Rüdiger Schaper u shpreh i lumtur që vepra e tij ka ardhur edhe në gjuhën shqipe. Ai po ashtu lexoi edhe një pjesë nga shkrimi i tij e që sjellë situatën "e sikletshme" në mes të aktorit Josef Kainz dhe Aleksandër Moisiut, në komedinë Tartufi ku Moisiu luante shërbëtorin Lorenzo. Aleksandri aty kishte harruar fjalët dhe kishte shtangur në mes të skenës gjersa Kainz interpretonte "Lorenzo, o shërbëtori im, a është gati veshja ime...?".

Harmonia filozofike e dy artistëve në një ekspozitë të përbashkët

Dy artistët e mirënjohur figurativ, Safet Spahiu dhe Bashkim Mexhiti, ekspozuan veprat e tyre artistike – skulpturat, në Galerinë "Shtëpia e Fellbahut" në Suharekë. Harmonia filozofike e veprave të tyre ishte forca e padukshme që i bashkoi këta dy artistët në një ekspozitë të përbashkët.

"I bashkoi kontrasti mes lirikës shumëngjyrëshe dhe larmisë abstrakte në pikturat e Bashkimit dhe fuqisë epike, që simbolizon demin në pikturat e Safetit, ose ecja apo shëtitja nëpër kohë e tablove të Bashkimit dhe qëndrimi stoik dhe real i demit. E përbashkëta tjetër është



se "hieroglifët" shumëngjyrëshe dhe abstrakte të Bashkimit flasin shqip, rrëfejnë për ngjarje historike, kurse figuracioni i demit, aq real dhe aq i fuqishëm, përmbush këto data e ngjarje të së kaluarës, që prezanton Bashkimi. Aty-këtu vërehet dukshëm edhe dyshimi, hutimi, po

pse jo edhe trishtimi i shkujdesur i demit, simbolikë e gjendjes momentale të banorit të këtij nënqielli", tha në hapjen solemne fotografi artistik Osman Demiri.

Ai shtoi se këto stile në këtë ekspozitë, shumë dallues mes tyre, përmbushin njëri-tjetrin duke

përforuar bindjen në thënie, se në art nuk është e rëndësishme vetëm ajo që thua, por mënyra dhe stili se si e thua.

Për veprat e Safet Spahiu dhe Bashkim Mexhiti foli edhe artisti nga Suhareka, Refki Gollopeni, ndërsa fjalë përshëndetëse mbajti edhe kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj.

Safet Spahiu ka lindur në Prizren, ndërsa prej vitit 1996 jeton dhe vepron në Gostivar. Prej vitit 1998 ligjëron në Fakultetin e Arteve pranë Universitetit të Tetovës. Ka realizuar 14 ekspozita personale në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri, Gjermani,

Francë, Turqi, Bullgari, Argjentinë, SHBA, Kore e Jugut. Për punën e tij krijuese disa herë është shpërblyer me çmime vendore dhe ndërkombëtare.

Bashkim Mexhiti ka lindur në Gostivar. Është njëri ndër themeluesit e Fakultetit të Arteve në Universitetin e Tetovës, ku ligjëron prej vitit 1994. Ka realizuar mbi 15 ekspozita personale me piktura, ndërsa ka krijuar edhe në skulpturë, siç janë shtatorët e Josif Bagerit, Xhemë Hasës, Aqif Reçanit dhe Komandant Tigris.

Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 15 prill.

“Ana Karenina” është një roman romantik tipik i letërsisë ruse, i shkruar plot me detaje që të mbeten në mendje, por që transmeton edhe një ngarkesë të fuqishme emocionale. Ana, personazhi kryesor i veprës, nuk e gjen veten gjëkund në martesën e saj dhe, pasi një aventurë jashtëmartesore, e gjen veten në shinat e trenit, e gatshme për t’u vetëvarë për mëkatin që ka bërë.

JA ÇFARË NA MËSON TOLSTOI ME “ANA KARENINËN”



Nëse gjatë gjithë veprës personazhi i saj transmetonte neveri për atë që i bënte bashkëshortit, në fund gjithsecili nga ne ndjeu dhimbje për vdekjen e saj. Këtë fuqi për të t’i ndryshuar komplet emocionet e kanë shumë pak autorë. Kujtojmë këtu se të njëjtin efekt na ofron edhe Flaubert me “Zonja Bovari”.

Tolstoy duket sikur e ka tejkaluar veten me romanin “Ana Karenina”, pasi i ka falur botës një kryevepër që ka kryesuar kushedi se e sa klasifikimeve për librat më të mirë, shkruan bota.al.

I nisur me fjalinë “Të gjitha familjet e lumtura janë njësoj, ndërsa familjet jo të lumtura janë të gjitha jo të lumtura në mënyra të ndryshme”, Leo Tolstoy na jep këto mësimet përmes kryeveprës së tij.

Jo çdo gjë që shkëlqen, është prej ari

Kur 18 vjeçarja Kiti u përball me dy djem që e pëlqenin, ajo zgjodhi Vronskin, në vend të Levinit. Ajo mendonte se Vronski ishte më i paraqitshëm dhe më sharmant, por pavarësisht se ai flirtoi me Kitin, më pas zgjodhi Anën dhe në fund i la të dyja me zemrën të thyer. Ndërkohë Levini, vërtet duket në fillim personazh antipatik për

lexuesin, por në fund rezultoi një partner shumë besnik.

Divorci duhet të jetë një zgjedhje e pranuar nga shoqëria

Romani është shkruar në një periudhë, kur divorci konsiderohej një tabu. Divorci ishte e kundërta e lumturisë, prandaj dhe përballë një fakti të tillë, Ana nuk divorcohej dot nga bashkëshorti i saj që nuk e bënte të lumtur. Por nëse e mendojmë mirë, një paragjykim i tillë për divorcin nga shoqëria e asaj kohe, na bën të mbajmë në duart tona një kryevepër të letërsisë botërore. Imagjinoni pak nëse Ana do të ishte ndarë prej bashkëshortit të saj. Sot nuk do të kishim një veprë të kësaj natyre.

Të martohesh në moshë të re, është një zgjedhje jo tepër e zgjuar

Vitet e fundit është vënë re një rritje e moshës mesatare të martesës. Mosha mesatare e martesës për femrat është 27, kurse për me-

shkujt 29 (në ndryshim nga 23 për femrat dhe 26 për meshkujt në vitet ‘90). Ky është një ndryshim shumë i mirë, pasi të dy partnerët janë më të përgatitur për jetën në çift. Tolstoy ndoshta nuk e parashikoi këtë tendencë të shoqërisë moderne, por ai ka shkruar në veprë për vështirësitë e martesës në moshë të re. Për të nxjerrë në pah pikëpamjet e tij, autori e vendos martesën e Levinit në moshën 32 vjeçare dhe që në fund të romanit, ai rezultoi të jetojë më i lumtur se personazhet e tjerë që marrohen më të rinj.

Ne nuk e kemi fuqinë të ndryshojmë “ligjet” e shoqërisë ku jetojmë

Ajo që është pjesë e shoqërisë sonë, kërkon kohë të ndryshojë. Normalisht, “ligjet” arbitrare të shoqërisë ishin të padrejta për Ana Kareninën. Të shqetësohesh për të dalluar “të drejtën” nga “e padrejta”

është tunduese dhe mund të jetë më pak produktive, se sa të mendosh për një mënyrë pozitive për të bashëpunuar me situatat e padrejta ekzistuese.

Romanca dhe dashuria e vërtetë ekzistojnë

“Ana Karenina” është natyrisht një tragjedi. Një femër rrezikon gjithçka që ka në emër të dashurisë së vërtetë, dhe arritja e një dashurie të tillë është fatale për të. Pavarësisht fundit tragjik, përgjatë gjithë veprës jepen mesazhe të shumta për dashurinë dhe lumturinë.

Levini dashurohet me Kitin që në momentin e parë që e sheh dhe nuk i ndalon përpjekjet e tij për ta bërë për vete, edhe pse ajo e refuzon. Çifti has vështirësi në momentet e para pas martesës, por në fund, krijon një jetë të lumtur bashkë.

Rutina nuk është e mërzitshme

Levini, që është personazhi më pozitiv në veprë, ndiqte një rutinë të njëjtë dhe ishte i lumtur me këtë pjesë, deri në momentin që miqtë e tij borgjezë e nxisnin të ndryshonte stilin e tij të jetesës. Nëse më parë ai zgjodhej shpejt dhe bënte punë fizike, ata e shtynin të shkonte në opera, apo të mernte pjesë në gossip. Këto aktivitete ai nuk i pëlqente aspak, pasi ndihej më mirë me rutinën e zakonshme që ndiqte më parë.

Askush nuk jeton një jetë të lehtë

Levini punonte me fshatarët që kishte punësuar dhe thuhet se Tolstoy ka bërë të njëjtën gjë në kohën e tij. Autori hapi shkollë për fëmijët e bujkrobërve të tij dhe i thurte punëtorëve lavde për meritat e tyre.

Ekspozitë e tre artistëve tetovarë



Tetovë, 9 prill - Në Tetovë, është hapur ekspozita kolektive me titull “Tradita si pikënisje artistike 2018”. Autorë të kësaj ekspozite kanë qenë Astrit Rexhepi, Berat Beqiri dhe Ylber Dauti. Artistët e rinj, përmes eksperimenteve profesionale dhe përvetësimit të teknikave grafike, krijuesit janë vënë në kërkim të individualitetit të tyre krijues. Krijuesit e rinj, duke bartur vlera autentike të ngritura mbi simbolet, metaforat, asociacionet, arrijnë të prodhojnë një hapësirë artistike. Për ndryshe, që të tre artistët kanë lindur në Tetovë, ndërsa që nga viti 2013 kanë marrë pjesë në shumë ekspozita kolektive. Astrit Rexhepi është anëtar i Shoqatës së artistëve figurative të Tetovës. Berat Beqiri është po ashtu anëtar i kësaj shoqate, kurse në vitin 2015 është emëruar Grafist i Vitit në Fakultetin e Arteve. Ylber Dauti po ashtu anëtar i kësaj shoqate, ndërsa në vitin 2014 është emëruar Grafist i Vitit në Fakultetin e Arteve.



12 RREGULLA PËR KRIJUESIT E RINJ NGA STEPHEN KING

Shumica e shkrimtarëve bien dakord që fjalia e parë është, mbase, më e rëndësishmja në një krijim letrar; fjalia e parë është ajo që fton lexuesin të nisë të lexojë. Shkrimtari i njohur Stephen King mendon se fjalia e parë është një lloj e rëndësishme si për lexuesin, edhe për shkrimtarin.


Në një intervistë për “The Atlantic”, King ndan disa këshilla ose, siç i quan ai, rregulla, për të gjithë krijuesit e rinj. Shumë prej tyre, më shumë sesa me shkrimin, kanë të bëjnë me ripunimin e tekstit.

1. Shkruaj për vete, më pas shqetësohu për lexuesit. Në fillim shkruaje historinë sikur po ia tregon vetes tënde. Më pas, gjatë ripunimit, hiq të gjitha pjesët që nuk kanë lidhje me përmbajtjen.
2. Shmangi ndajfoljet; nuk janë miq të mirë.
3. Mos u fikso pas gramatikës. Qëllimi i letërsisë fikson nuk është korrektesa gramatikore, është ta mbajë lexuesin të interesuar.

4. Beso në vete. Jam i bindur se frika është arsyeja e letërsisë së dobët.
5. Lexo, lexo, lexo. Nëse nuk ke kohë të lexosh, nuk ke kohë të shkruash.
6. Mos u përpiq të kënaqësh të tjerët. Është e pamundur t’i kënaqësh të gjithë.
7. Fike televizorin, është gjëja e fundit për të cilën ka nevojë një shkrimtar.
8. Ka dy sekrete për të qenë i suksesshëm, të paktën për mua: Jam i shëndetshëm dhe i martuar.
9. Qëndroi besnik stilit tënd.
10. Pusho! Lexoje librin tënd pas 6 javësh. Do të jetë një eksperiencë interesante.
11. Mos përfshi në tekst pjesët e mërzitshme dhe... vriti personazhet e tu të dashur, gjithmonë.
12. Shkruaj për të qenë i lumtur. Mos shkruaj për para, për t’u bërë i famshëm, për të bërë miq apo për të zënë të dashur. Letërsia është magjike, ashtu siç është uji për jetën. Uji është falas. Pra, pi!

Një stilist i përsosur

Josif Brodski (Leningrad, 24 maj 1940 – New York, 28 janar 1996), poet dhe eseist rus, fitues i Çmimit Nobel për Letërsi për vitin 1987. Josif Brodski ka qenë i biri i një familjeje hebreje ruse nga Shën Peterburgu. Gjatë fëmijërisë së vet, ai i mbijetoi Rrethimit të Leningradit. Brodski e filloi krijimtarinë e tij letrare dhe punën e përkthyesit rreth vitit 1957. Shkrimet e tij të para qenë tërësisht të paangazhuara politikisht. Në vitin 1963 ndalohej dhe me pas dënohet për parazitizëm nga autoritetet e Bashkimit Sovjetik. Gjatë kësaj kohe, ai refuzoi të botonte të censuruara veprat e tij. Në vitin 1972 shpërngulet në Amerikë ku botoi dhe disa vepra. Ka shkruar: Xhon Donin dhe poema të tjera (1967), Poema të zgjedhura (1973), Vargje të një fushate dimërore (1980), Zbulime (1999), Poemat e lindjes (2001) etj. Poeti nobelist Josif Brodski (1940-1996), Nobeli 1987, ka lënë jo vetëm një trashëgimi të jashtëzakonshme në gjuhën ruse dhe në atë angleze: poezi, vepra dramatike, studime, ese, përkthime, por edhe mendime të thella dhe gjykime shumë origjinale mbi figurën e poetit, gjuhën e poezisë dhe procesin krijues poetik, mbështetur në përvojën e vet krijuese dhe në atë të figurave të shquara të poezisë botërore, të së kaluarës së largët dhe të viteve më të afërta, të Kavafis, Montale, Mandelstam, e të tjerë. Ishte i përndjekur në vendin e vet dhe u dëbua nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1972. U vendos përfundimisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku zhvilloi aktivitetin e tij krijues si shkrimtar dhe si pedagog, duke shkruar poezi, kryesisht në gjuhën ruse, kurse eseistikën vetëm në gjuhën angleze. Stili poetik i Brodskit është vlerësuar për koncentrimin e lartë të përmbajtjes dhe formën e lartë poetike, për intelektualizmin dhe frymën e thellë filozofike, ironinë dhe fjalën e mençur të poezisë së tij, për novatorizmin e metaforës; ai është një stilist i përsosur; gjuha e tij poetike dallohet për gërshetimin e gjuhës së gjallë shumështrësore gërshetuar me arkaizma, dialektizma, terma speciale shkencore; poezia e tij synon ekuilibrin e poetikes me prozaiken, figuracioni nuk është abstrakt; sintaksa e tij poetike nuk përdor fare fjalitë e thjeshta, por sinon frazat e komplikuar, me të cilat arrin dinamikën e zhvillimit pa fund të mendimit, duke synuar vërtetësinë më të lartë artistike. Në një intervistë ai pohon: "Gjithë poezitë e mia, disa më shumë e disa më pak, flasin për të njëjtën gjë, për Kohën". Krijimtaria e tij poetike i përket një kategorie universale, e cila është në gjendje ta frenojë kohën, ta mundë atë. Dhe këtë poeti e arrin me anën e Gjuhës. Brodski ka një vizion të vetin për poetin, për stilin e punës krijuese dhe, në mënyrë të veçantë, për procesin e krijimit të figurës artistike. Krijimin ai nuk e quan aspak një punë mekanike, si një mjeshtëri të çfarëdoshme, zanat, por si një krijim ku merr pjesë ndjeshmëria e tij dhe procesi i njohjes, që e përshejton në maksimum procesin krijues.



Josif Brodski

DASHURIA

Dy herë u zgjova sonte këtë natë dhe shkova drejt dritares ku fenerët, si pikat e një fraze mbetur n' erë, një fraze të këputur aq të gjatë, s' më dhanë qetësi mua as prehje. Në ëndërr ti shtatzënë m' u fanite, megjithëse prej vitesh ishim ndarë, gabimi më i rëndë si një barrë, duart përmbi bark duke rreshqitur, kërkoni nëpër pantallonat çelësin. E dija duke shkuar drejt dritares së vjetër në errësirë, në ëndërr, duke pritur me dëshirë dhe fatin nuk ma hidhe aspak mua dhe as kësaj ndërprerjeje të shtirë, sepse në errësirë zgjat gjithmonë ajo që u ndërpre dikur në dritë. Ne ishim të martuar ato ditë përbindsha lakuriq e me kurorë, dëshmi e saj në ishin vetë fëmijët. Do vijë dita, mbase, do të kthehesh një natë dhe e lodhur dhe e dobët dhe unë do ta shoh fëmijën tonë, një djalë a një vajzë të paemër dhe nga çelësi do ta heq dorën. Nuk do ta zgjat, nuk kam aspak të drejtë t' ju le në mbretërinë e errësirës, në atë heshtjen plumb të hapësirës, fundosur nga kjo gjendje e vërtetë, nga kjo dëshira ime e paarrirë.

NGA ASGJËKUNDI

Nga asgjëkundi në një datë të padatë, e nderuara dhe e shtrenjta ime e dashur, me dashuri, rëndësi s' ka se nga kush e prej kujt është dërguar, ju përshëndes që prej njërit kontinent të kësaj bote, kontinentit që mbahet nga supet e kaubojve, të kam dashur më shumë se ëngjëjt dhe veten, prandaj jam tani larg prej tyre e prej teje; natën vonë në luginën e përgjumur, në fund të saj, në qytezën me dyert e zëna nga bora, përpëlitem e sillem rrotull nëpër çarçaf, si më poshtë ky varg do të ta tregojë, e shkruftoj unë jastëkun me rënkimin tim

përtej detesh, oqeanesh, që fund e mbarim s' kanë, me trupin tim skicoj format që ke ti si pasqyrë e menduar, që nuk gjen dot prehje.

NË KAFENE

Nën kurorën e rrapit që fëshfërit "fësh-fësh" dhe e bën kafenenë sikur s' ekziston më, vend si të tjerët, si çdo dru që fëshfërit, gjelbërimi është i përjetshëm. Rrap qoftë a lis, si të thuash, nuk jam askush dhe jam çdo njeri, një njollë e tharë në tablonë plot gjallëri që jeta e shkruan me penelin e saj vetë siç nuk ka një palitër tjetër në jetë. Shfletoj gazetën "fësh-fësh" i menduar, nga cili model kjo është skicuuar, pa adresë, pa emër; formën e mosekzistencës përsëritim rrapit edhe unë këtë mbrëmje të verës.

NË SHEKULLIN TJETËR

Dalngadalë realiteti shndërrohet në realitet. Ti lexon këto gërma që la pena mbi letër dhe e krahason atë me breshkën për ngadalësinë që të fut në siklet. Mos harro: lenë apartamentin njerëzit kur qiraja rritet, bëhen shkurttime hata; thjesht, e ardhmja e do këtë banesë pa ata. Le të marrim yllnajat, si me thënë, deri sa shpejtësia e tyre llaftari, ato nuk janë të pranishme as tani për pasojë të mosqënies. Akuzat, me vite, bëhen më të rëndësishme se krimi, ditët më të rëndësishme se jeta, me shenja pikësimi zëvendësohet zëri. Megjithëse ndaj teje s' ka pretendime as për teleskop, as për kujtime.

ELISAVETA LESKAJËS

Ka ngrirë ajri dhe drurët halorë veshim xhupat edhe gëzofët, Me torbën në sup nëpër borën e pushtë më mirë dre se gamile dygungshe. Në se besojnë këtej në një Zot, me komandantin e burgut ngjason,

burgun ku brinjët të dhembin, të therin dhe të thërresin, do ca të tjera! Në jugë ku bie dëborë aq pak, besojnë në Krishti, q' u ngjan endacak: u lind shkretëtirës, në rërë dhe kashtë dhe vdiq, siç thonë, prapë përjashta. Le ta kujtojmë me verë e sime jetën që rrodhi nën qiellin plot dritë, që t' i shpëtojme arrestit të dhunshëm për deri sa toka ka vend aq shumë.


KUJTIMIT TË TROMPISTIT KLIFORD BRAUN

Kjo nuk është ngjyra blu, është ngjyra e akullit. Nuk është ngjyra e oqeanit Atlantik, s' ka rëndësi se ti ke veshur pallto, mbi akullnajë je shtrirë lakuriq. S' është thjesht akull, është kallkan, i ngrohtësisë është armiku, ajo dhe ti të vetëm nëpër oqean, zëri i trompës sate është ngjirur. Zëri yt errësirës nuk rënkon, gishti yt ka ngrirë përmbi diezë,, pik' e ndritur drejt zenitit lundron ta shohë botën nga ana tjetër. S'është rrejtja e meridianëve që ndërpritet, por fletorja ku notat yje shtrihen, akullnaja s' shkrin si pika e dritës, drejt kulisave të polit shkon të fshihet.

NË NJËQINDVJETORIN E ANA AHMATOVËS

Fletën dhe zjarrin, kokrrën dhe mokrën, kosoren e mprehtë dhe flokun e prerë i ruan si zërin e vet përgjithmonë Zoti, si fjalët e dashurisë dhe shpresës. Në to rreh pulsi i ndërprerë, dëgjohet krism' e eshtrave dhe lopat' e hekurt troket ritmikisht dhe mbytur, sepse vetëm një është jeta, ato më qartë kumbojnë nga buzët e vdekura se sa në efir. Shpirt i madh, të përulëm prej përteji ty dhe trupit tënd të tretur, që fle në dhë të vet, që nëpërmjet teje kjo tokë e rigjeti gjuhën e ligjëritimit në universin shurdhmemec.

Përktheu: VANGJUSH ZIKO



Lufta për tu bërë shkrimtar

Pyesni Pluhurin, është një roman i vitit 1939 nga shkrimtari John Fante. Ky është një nga romanet më të famshëm të tij, si dhe pjesë e ciklit autobiografik, i përqendruar në karakterin Arturo Bandini-t. Publikimi fillestar i romanit nuk ishte shumë i suksesshëm. Popullariteti i tij arriti kulmin falë Charles Bukowski-t, pasi ishte pikërisht ky libër që e ndikoi në mënyrë të konsiderueshme atë, duke vendosur dhe parathënien në momentin kur libri u ribotua. Ishte pikërisht kjo parathënie e tij, që i dha popullaritet dhe famë librit dhe autorit John Fante. "Bota ishte pluhur dhe në pluhur do kthehej". Një shprehje e thënë nga vetë personazhi kryesor, që duket sikur kur i thotë këto fjalë parackton dhe fatin e tij. Pyesni pluhurin, është i libri dyti i triologjisë së John Fante-s me në qendër personazhin Arturo Bandini, një personazh që vuante prej ëndrrave në rrethinat e varfëra të Los Angeles. Ai është një i ri italo-amerikan që ka ëndërr të bëhet shkrimtar dhe në këtë libër ne do shohim ambicien për të realizuar ëndërrën e tij të dëshiruar, problemet ekonomike si dhe ato me dashurinë. Vetëm në fund Fante e kap këtë personazh nga aspekti shpirtëror.


Duket sikur autori me këtë personazh dhe me sfidat që i ka vendosur në këtë roman dëshiron të tregoj shpresën dhe luftën e të gjithë idealistëve, që kanë të njëjtën ëndërr si Arturo Bandini, dhe ashtu si ai, po të njëjtin fund. Një roman plot emocione, me një stil unik, ku lufta për tu bërë shkrimtar e protagonistit na tregon dhe luftën për mbijetesë të Bandini-t, duke e përballur gjithashtu atë dhe me luftën për një dashuri të humbur. Kush fiton? Arti, ëndrra e Arturo Bandini-t për tu bërë pjesë e letërsisë, për të botuar një shkrim të tijin. (Republika e Librave)

Një dritëhije në tunelin e Ernesto Sabatos

Romanin "Tuneli" të Ernesto Sabatos, e kam marrë dhuratë përpara pak ditësh nga miku im Besarti. Ma kishin sygjeruar shumë herë t'a lexoja këtë roman, por nuk e kisha gjetur dhe kur mora vesh që ai e kishte gjetur këtë libër për mua, u ndjeva shumë kurioze për të shfletuar faqet e tij. Që kur lexova paragrafin e parë e kuptova se pse ky ishte një libër që kishte bërë aq shumë bujë. Një hyrje me dy fjali të thjeshta që përmbanin një thesar letrar dhe nevojë për të ditur se pse Juan Pablo Casteli ka vrarë Marian, gruan e vetme që ka arritur ta kuptojë. Tek kaloja nga faqe në faqe nënvizojta sjelljet e personazhit, interpretimin e tij për veten dhe mënyrën sesi ai mendonte se e shihte Maria. Që në kontaktin e parë me Marian, arrin të shohësh thellësinë e imagjinatës së këtij personazhi, por mbi të gjitha një lloj fiksimit të kthyer në kusht për mbijetesë. Pasi e përfundova romanin e gjeta veten të shokuar, por dhe shumë konfuze. E para sepse nuk isha e qartë nëse Casteli ishte në një vijë të drejtë me botën, apo ecte gjithmonë në tunelin e tij ku askush nuk arrin të depërtonte sepse nuk hiqte dot vija paralele.

E dyta sepse Maria është personazh kompleks dhe i pazhvilluar, ndonëse shfaq një portret enigmasht të zgjidhshme, por jo të pranueshme. E treta, në këtë roman është e vështirë të ndash kufirin e fiksimit me dashurinë, të besimit dhe çmendurisë. Mendoj se dhe vetë Casteli nuk e ka akoma të qartë këtë gjë. "I çmendur" fjalja e fundit që Casteli merr si përgjigje për veprimet që bën, e lenë dhe atë në pikëpyetje për rrëmujën që ka krijuar me jetën e tij, hamendësimet dhe mbi të gjitha interpretimin e realitetit siç ia do atij qejfi.

Si në çdo lexim unë gjithmonë ngre pyetje, për librin, për të arritur ta kuptoj më mirë. Ndaj kam dhe unë nevojë për një përgjigje nga lexuesit e tjerë të këtij romani. Kush të shëndrro në vrasës, dashuria apo mania për të zotëruar dashurinë? (Flogerta Krypi)



Bukuria vetëshkatërruese

Portreti i Dorian Greit një histori që trajton të bukurën në një mënyrë ndryshe nga çdo libër tjetër. Kjo histori është një gjetje e mrekullushme për të shpjeguar më mirë çfarë do të thotë "të qenit narcist". Libri për këtë përqendrohet tek personazhi kryesor Dorian Grei i cili shet shpirtin në këmbim të bukurisë dhe rinisë së përjetshme, dhe për këtë ai zhytet në jetën e krimin dhe të epshit të pa fund. Trupi i tij mban rininë dhe gjallërinë, por portreti i tij i brendshëm është e kundërta e asaj që tregon sipërfaqja. Mënyra e përshkrimin nga autori, që na tregon se si e mbart ky personazh të veshur në trup rininë e përjetshme, na bën që në imagjinatën tonë ta shohim vërtet si një maskë, si një maskë që nga e bukur në fund bëhet vetëshkatërruese. Portreti i këtij personazhi adreson më shumë se një temë, dhe besoj se çdo lexues teksa lexon nëpër rreshta arrin ti bëjë pyetjen vetes: "A duhet dashur vetja kaq shumë, deri në tepri, aq sa të krijohet ndjenja e tjetërsimit të vetes?"

Përgjigja të vjen nga vetë autori Oscar Wilde, i cili përgjigjen e kësaj pyetjeje na e përmbledh në fjalën egoizëm, "egoizmi është fillim i një pasioni të përjetshëm", thotë ai. Pra nëse bazohemi dhe tek historia e Dorian Greit është një pasion, i cili nuk do të zhduket, por përkundrazi do të zhvillohet dhe madje do të përparojë deri në pafundësi.

Ky roman përpos kesaj, është gjithashtu një shembull klasik i estetizmit të letërsisë angleze, kjo na reflektohet që në hapjen e tij, i cili specifikon qëllimin e artit, "zbulimi i artit dhe fshehja e artistit". Për ta kuptuar më qartë po ju citoj disa nga fjalët e personazhit piktor Basil, "Artisti duhet të krijoj gjëra të bukura por nuk duhet të përfshijë asgjë nga jeta e vetë". Jetojmë në një epokë në të cilën njerëzit e trajtojnë artin si një lloj forme autobiografike. Kemi humbur kuptimin e bukurisë abstrakte". Kjo sjell një mesazh të fortë për çdo lexues dhe të tërheq për të lexuar më shumë dhe për të kuptuar më shumë rreth kësaj filozofie. (Xhoana Sulaj)

Historia e një gruaje të hekurt gjermane

Ndryshimi i këtij libri me gjithë të tjerët është se në këtë libër gjendet romani dy mujor i një gruaje që rrëfen se ç'ndodhi me Berlinin kur trupat Sovjetikë hyn në Gjermani dhe lufta po mernte fund. Unë e njoh mirë Berlinin, pasi kam jetuar atje, por të lexosh se ç'kanë bërë në të, të dhemb lëkura, të duket sikur po të shtypin kokat. Gjermania ishte në prag kapitullimi. Të gjithë botën e kishin kundër, por faturën për këtë luftë e paguan gratë gjermane, të cilat për të thënë të vërtetën dhe e ndëruan Gjermaninë pas luftës. Hyrja e trupave sovjetikë përshkruhet aq thjeshtë dhe qartë, saqë e dyshova nëse kjo autore anonime, kishte të bënte me letërsinë. Më pas pasi e kisha përfunduar librin, lexova që ajo ishte një gazetare, që nuk lejoi kurrë t'i zbulohet identiteti dhe veç pas vdekjes së saj u botuan këto ditar origjinal pa asnjë censurë.

Teksa lufta ishte në përfundim, gratë gjermane u gjenden të vetme dhe të pambrujtura nga prurjet në Berlin. Qyteti ishte kthyer në gërmadhë, nuk gjenin ushqim dhe një pjesë e tyre përdhunoheshin vazhdimisht, madje disa herë në ditë. Një fat të tillë e pati dhe autorja e këtij ditari, që i rrëfen ngjarjet aq ftohtë, aq qartë, pa shtuar apo pa hequr të vërtetën, ashtu siç ajo e shihte, pa mbajtur krahun e askujt. Për dy muaj me rradhë, kjo grua në Berlin i qëndron besnike qytetit të saj dhe të vërtetës. Mes gjithë asaj lufte që po bënin trupat Sovjetikë mbi gratë gjermane, ajo ia doli të mbijetonte. Kur e kam përfunduar këtë libër, realisht kam vuajtur shumë. Marrëdhënia ime me Berlinin gjente një lloj shpjegimi në këtë libër dhe pse në dy kohë kaq të ndryshme.

Të gjithë duhet ta lexojnë këtë libër, jo vetëm ata që duan librat bazuar në ngjarje të vërteta apo histori. Të gjithë duhet të njohin një pjesë tjetër të historisë, të cilët sot nuk e konsiderojnë të rëndësishme. Në fund të fundit sipas botës ato gra gjermane thjesht paguan faturën për një luftë që e nisi shteti i tyre. E megjithatë unë e shoh ndryshe. Libra si ky apo dhe shumë vizita në vende ku Lufta e Dytë Botërore është ende e prekshme, më kanë krijuar një lloj vizioni të qartë për atë çfarë ka ndodhur atëherë dhe po ndodh dhe sot në fakt. Një grua në Berlin është një ditar i jashtëzakonshëm, ku autorja ka shërbyer thjesht si një lloj sfungjeri, ka thithur çdo gjë dhe e ka nxjerrë jashtë, duke e shkruar, pa shtuar qoftë një ndjesi të vetme personale. Një libër që nuk duhet humbur! (Flogerta Krypi)



NDARJA E KOSOVËS NDAN BEOGRADIN DHE PRISHTINËN

Ideja për ndarjen e Kosovës ka rrjedhur nga Beogradi nga ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić dhe ajo nga zyrtarë vendorë e ndërkombëtarë në Prishtinë është pritur pothuaj me thikë



Ndarja e Kosovës është temë e dy anëve të kufirit që i ndan krejtësisht Beogradin e Prishtinën. Të dy këto qendra lidhur me ndarjen kanë qëndrim e diametralisht të kundërt. Derisa në Beograd kjo temë nuk është tabu, në Prishtinë për këtë variant flitet vetëm në kontekstin negativ.

Ky qëndrim i Prishtinës, për portalin rus sputnjik që botohet edhe në serbisht, është i çuditshëm sepse, siç shkruan ai, nëse Kosova dëshiron që problemin me Serbinë ta zgjidhë përgjithmonë, ndarja është shans, pos nëse shqiptarët nuk kanë plane të tjera. Pse është e papranueshme ndarja e Kosovës për Prishtinën dhe për mentorët e saj perëndimorë dhe a mendojnë ata se koha do ta bëjë të veten ashtu që Serbia të vijë në si-

tuatë për njohur Kosovën, pyet portali. "Përgjigjen" për këtë në këtë portal e ka dhënë analisti politik Dragomir Angjelković.

Sipas tij, transmeton Koha.net, është mit të thuhet se koha punon për Prishtinën pasi po ndryshon politika globale dhe kjo nuk u shkon për shtati shqiptarëve. Prishtina nuk dëshiron të flasë për ndarjen sepse e ka agjendën e vet kombëtare të vijëzuar kaheerë. "Për ta zgjidhja e përhershme është krijimi i Shqipërisë së madhe. Kur të vijë momenti i ndarjes së Maqedonisë dhe ekspansionit në jug të Serbisë dhe një pjesë të Malit të Zi. Të gjitha ato që po ndodhin

tash për ta është marrja e pozicionit, pra start pozicionues sa më të mirë. Sepse shqiptarët, po ta kishin qëllim rrumbullakimin e shtetësisë, ata do të ishin të gatshëm për kompromis. Meqë këtë s'e kanë qëllim, por e kanë qëllim krijimin e Shqipërisë së madhe, atëherë edhe nuk pranojnë kurrfarë ndarjeje", thotë Angjelković. Perëndimi lidhur me ndarjen e Kosovës është në një vijë me Prishtinën. Zyrtarë të tij mendojnë se Kosova është tregim i përfunduar brenda kufijve në vitin 2008 kur u shpall pavarësia e saj. Pyetjes se a e ka Prishtina për qëllim krijimin e Shqipërisë së madhe dha është Perëndimi në

shërbim të kësaj ideje, Angjelković përgjigjet: "Mentorët perëndimorë të Prishtinës duan të kenë krizë të hapur, ata s'i kanë parasysh as serbët e as shqiptarët, por e bëjnë lojën e madhe gjeopolitike me Rusinë. Përpiqen që edhe Gjermaninë ta mbajnë në pat-pozicion, ashtu që në oborin evropian mund të bëjnë gjithmonë probleme. Në thelb, atyre u përgjigjet më shumë kriza e hapur se sa ajo e mbyllur". Ideja për ndarjen e Kosovës ka rrjedhur nga Beogradi nga ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić dhe ajo nga zyrtarë vendorë e ndërkombëtarë në Prishtinë është pritur pothuaj me thikë.

LDK nis "rrëzimin" e Qeverisë

LDK-ja këtë javë do t'i fillojë procedurat për rrëzimin e qeverisë "Haradinaj". Zyrtarët e kësaj partie kanë konfirmuar për gazetën "Zëri" se në ditët në vijim do ta fillojnë iniciativën zyrtare për ngritjen e mocionit ndaj Qeverisë. Zyrtarët e "Vetëvendosjes" thonë se nuk do ta mbështesin iniciativën e LDK-së Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila tash e një kohë është duke kërkuar që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare, pritet që këtë javë t'i nisë zyrtarisht procedurat për ngritjen e mocionit për rrëzimin e Qeverisë. Teksa kanë njoftuar për një gjë të tillë, përfaqësuesit e këtij subjekti kanë thënë për "Zërin" se zgjedhjet e parakohshme paraqesin zgjidhjen e vetme për daljen e vendit nga kriza. Megjithatë, përfaqësuesit e lëvizjes "Vetëvendosje" kanë bërë të ditur se nuk do të bëhen pjesë e LDK-së në të tilla çështje. Sipas tyre, iniciativa për rrëzimin e Qeverisë do të jetë nga LVV-ja e jo nga LDK-ja. Kjo pasi që, ashtu siç janë shprehur ata, Lidhjes Demokratike nuk i intereson ndërrimi i qeverisjes, porse kryekëput marrja e pushtetit. Pavarësisht këtyre, përfaqësuesit e PDK-së (partnerit më të madh të koalicionit qeverisës) kanë konsideruar se nuk ka seriozitet dhe vendosmëri të opozitës për t'i dhënë fund qeverisjes aktuale. Megjithatë, ndonëse ata shprehen të bindur se këtë vit s'do të ketë zgjedhje, 2019-a sipas tyre mund të jetë vit i zgjedhjeve të parakohshme

Dekada e shkeljeve kushtetuese

Në mesin e shkeljeve më të rënda vlerësohen: Marrëveshja e vitit 2015 për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe; shkelja nga presidenti Fatmir Sejdiu; shkelja në rastin e presidenti Behgjet Pacolli; deportimi i gjashtë gylenistëve në Turqi



Më 9 prill 2008 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Kushtetutën e Republikës, të shpallur dy muaj më herët. Në dekadën e parë të kësaj kushtetute vlerësohet se janë bërë disa shkelje të rënda nga zyrtarët e lartë, institucionet e madje se ka pasur edhe interpretime jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese. Në

dekadën e parë Kushtetuta e Republikës së Kosovës përveçqë nuk është respektuar në lokalitetet me shumicë serbe, është sfiduar e madje është shkelur në disa raste edhe nga vetë krerët shtetërorë apo nga institucionet e vendit. Madje, vlerësohet se Kushtetuta në disa

raste është nëpërkëmbur apo nuk është respektuar as nga vetë gardiani i saj - Gjykata Kushtetuese përmes disa interpretimeve të cilat sipas ekspertëve të çështjeve kushtetuese nuk kanë qenë të bazuara në Kushtetutë dhe kanë qenë kontradiktore. Në mesin e shkelje-

ve më të rënda vlerësohen: Marrëveshja e vitit 2015 për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe; shkelja nga presidenti Fatmir Sejdiu; shkelja në rastin e presidenti Behgjet Pacolli; deportimi i gjashtë gylenistëve në Turqi; si dhe interpretimi i vitit 2014 i Gjykatës Kushtetuese, kur ua pati mohuar shumicës parlamentare formimin e qeverisë me arsyetimin se mandatarin për formimin e saj mund të propozohet vetëm nga partia fituese.

Njohësi i çështjeve kushtetuese Durim Berisha në 10-vjetorin e ditës së Kushtetutës ka thënë për gazetën "Zëri" se akti më i lartë juridik në vend ka një varg të metash. Sipas tij, në Kushtetutën e Kosovës ka kundërthënie e mungesë të qartësisë në formulim. "Dokumenti kushtetues të cilin pa të drejtë e kemi emërtuar Kushtetutë (sepse nuk mund të quhet e tillë përderi-

sa nuk është aprovuar drejtpërdrejt nga populli i Kosovës), pavarësisht që është hartuar në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar, ka një varg të metash, duke filluar nga struktura e saj, kundërthënie, zbrastëritë dhe mungesa e qartësisë në formulim", ka deklaruar Berisha. Ai më tej ka thënë se Kushtetuta në këto 10 vjet nuk ka gjetur zbatim në tërë territorin e Kosovës. "Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk ka gjetur zbatim në tërë territorin e Kosovës.

Por, shqetësues në të njëjtën kohë mbetet edhe dështimi i autoriteteve publike, me theks të veçantë organet administrative dhe gjyqësore, për ta garantuar një standard minimal të zbatimit të lirive dhe të drejtave themelore. Viktimë e këtyre veprimeve mbetet qytetari i Republikës së Kosovës", ka vlerësuar Berisha.

(Gazeta Zëri)

Kush është Sergej Skripal, agjenti i helmuar me gaz nervor që e ka ftohur keq marrëdhënien jo vetëm mes Britanisë së Madhe e Rusisë, por edhe perëndimit e Kremlinit? Kur e pse ndodhi kalimi i tij tek britanikët?

SERGEJ SKRIPAL, SPIUNI QË ÇOI NË KËMBË GJITHË BOTËN!

Emri i Sergej Skripal, agjentit rus që u bë agjent i dyfishtë duke punuar edhe për britanikët u fut në fokusin e shërbimit sekret të inteligjencës, ndërsa ai punonte në Madrid tek zyra e atasheut ushtarak të Moskës, për shërbimin sekret ushtarak të Rusisë, GRU. Sergej Skripal lindi në Kaliningrad në vitin 1951, pas shkollimit ai iu bashkua ushtrisë, para se të kalonte tek shërbimi sekret ushtarak, GRU.

I vendosur në Maltë ai tregoi aftësi si agjent, duke bërë që më vonë t'i ofrohet një post në kryeqytetin spanjoll, Madrid. Megjithëse ai ishte zbuluar si një aset i mundshëm edhe për shërbimin sekret spanjoll, Skripas përfundoi si agjent i MI6, pikërisht në Spanjë. Kjo ndodhi në epokën e Boris Yeltsinit, kur paratë rridhnin me pikatore në Rusi. Zyrat e shërbimit sekret rus jashtë vendit shpesh nuk paguheshin për periudha të gjata. Sipas raportimeve, arsyt e kalimit të tij në krahun britanik ishin financiare. Gazeta britanike The Times ka njoftuar se MI6 i dha spiunit rus pseudonimin "Fortwith". Sipas The Times, Skripalit i kërkoheshin informacione dhe detaje për koordinatat dhe vendndodhjen e agjentëve ruse kur ata zhvillonin takime. Me gjasë informatat përfshinin agjentë në vende të ndryshme europiane. Më vonë Skripal për shkak të problemeve shëndetësore u dërgua në Moskë të punonte në shtabin e GRU. I kthyer në Rusi ai u diagnostikua me diabet. Megjithëse Sergej Skri-



TRAGJEDI PERSONALE

Ai ishte një katër operativët perëndimore, që u dërguan në drejtimin e kundërt, i falur nga presidenti i atëhershëm rus, Dmitri Medvedev. Lirimi i Skripalit u bë me ndihmën e qeverisë britanike, prandaj Britania e Madhe ishte vendi ku ai u vendos. Ai bleu një shtëpi në Salisbury, por në vitet e mëvonshme iu desh të përballej me disa tragjedi personale. Gruaja Liudmilla ndërroi jetë nga kanceri në vitin 2012, djali i vdiq në korrik të vitit të kaluar në moshën 43 vjeçare gjatë një vizite në Shën Peterburg. Ende nuk janë sqaruar rrethanat e vdekjes së tij. Po ashtu edhe vëllai i tij 68 vjeçar, Valery, që shërbeu në ushtrinë ruse, ndërroi jetë dy vjet para se ish-agjenti të helmohej me vajzën e tij 33-vjeçare Yulia në Salisbury.

pal pushoi së punuari për GRU në vitin 2000, ai vazhdoi të mbante një punë në qeverisjen lokale në Moskë duke qenë kështu i aftë të siguronte informacione të rëndësishme.

Kërkesa për para ka qenë me sa duket faktori konstant i an-

gazhimit të tij. Nga Moska, ai vizitonte rregullisht Malagan, ku MI6 i kishte siguruar një shtëpi, ku merrte pagesat. Nëse ai nuk mundej, shkonte bashkëshortja e tij, Liudmilla.

Skripal u kap nga autoritetet në vitin 2004. Ai ishte jashtë shtë-

pisë së tij në rajonin e Krylatskoyes kur u fut në një mikrobus me xhamat të errët, i sapo kthyer nga një vizitë në Britaninë e Madhe. "Ju më mundët", thuhet se i ka thënë Skripal FSB-së. Shërbimi sekret rus, FSB e akuzoi atë se është rekrutuar nga shërbimi inteligjent britanik në vitin 1995. Dy vite më vonë Skripal u dënua për "tradhti të lartë në formë të spiunazhit" me 13 vite burgim në një burg të sigurisë së lartë. Agjenti i dekonspiruar mori një dënim relativisht të lehtë për shkak të bashkëpunimit me autoritetet. Skripal pati fat, kur 10 agjentë rusë u dërguan në SHBA pas zbulimit të tyre si pjesë e një rrjeti të fshehtë të spiunëve, që paraqiteshin si amerikanë normalë në këtë vend.

Izraeli sulmon bazën ajrore të Asadit

Ministria ruse e Mbrojtjes ka njoftuar se avionët izraelitë kanë gjuajtur tetë raketa drejt një baze ajrore në provincën Homs të Sirisë, pesë prej të cilave janë ndërprerë nga forcat ajrore të regjimit. "Në datën 9 prill, nga ora 03:25 deri në 03:53 sipas orës së Moskës, dy avionët F-15 të forcave ajrore izraelite, pa hyrë në hapësirën ajrore siriane, nga territori i Libanit, gjuajtën tetë raketa në bazën ajrore Tiyas. Tre raketa arritën në pjesën perëndimore të aerodromit, pesë u shkatërruan nga forcat ajrore të mbrojtjes të Sirisë", tha ministria ruse në një deklaratë me shkrim. Më herët, Observatori Sirian për të Drejtat e Njeriut pretendoi se sulmet ajrore vranë 14 persona, përfshirë qytetarë iranianë në bazën ushtarake pranë qytetit Homs në Siri. Edhe regjimi sirian po ashtu ka konfirmuar se një bazë ajrore u godit nga një sulm me raketa. Sipas agjencisë së lajmeve të regjimit (SANA), bombardimi shënjestroi bazën ajrore "T4" në provincën qendrore Homs në 4:00 të mëngjesit, sipas orës lokale. Agjencia tha se bombardimet vranë disa persona dhe plagosën disa të tjerë, por nuk dha numër të saktë.



Krime lufte në Gazë

Kryeprokurojta e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Fatou Bensouda, shprehu shqetësim për shkak të valës së paradokshme të dhunës në Gazë, duke vlerësuar se është e mundur që Izraeli dhe Hamas të kenë kryer krime lufte. Ajo në kumtesë shprehu "shqetësim të madh" për shkak të përdorimit të armës nga forcat izraelite ndaj palestinezëve gjatë protestës masive përgjatë kufirit të Gazës me Izraelin. "Dhuna ndaj civilëve në situatën në të cilën është Gaza, është e mundur të paraqet krim lufte", thekson ajo në kumtesë. Të paktën 30 persona janë vrarë kur forcat izraelite hapën zjarr, ndërsa Izraeli pohon se protestat janë "perde" për sulme mbi armatën e saj.

Sërish Orbani, BE të përgatitet për konfrontim të ri

Kryetari i qeverisë hungareze, Viktor Orbán, kritikoi ndaj BE-së dhe partia Fidesz nacionale e djathtë ka arritur fitore të thellë në zgjedhjet parlamentare në Hungari. Sipas llogaritjeve aktuale, partia e tij fitoi 48,5% të votave. Me këtë Fidesz mund të arrijë dy të tretat e kërkuara për të bërë madje edhe ndryshime kushtetuese. Ndërsa partia ekstremiste e djathtë, Jobbik ka fituar sipas llogaritjeve të fundit rreth 20% të votave. Lista e majtë, MSZP-P ka arritur vetëm 12%. Krerët e këtyre partive të majta pas dështimit në zgjedhje bënë të ditur dorëheqjen. Në votime ka pasur një pjesëmarrje të lartë, rreth 70% e vo-



tuesve. Pas përfundimit të votimeve e rezultateve të para, Viktor Orbán doli para përkrahësve të tij duke bërë fjalë për "një fitore historike." Ky rezultat u jep njerëzve mundësinë të "vetëmbrohen dhe të mbrojnë Hungarinë", tha ai. Fi-

torja e Viktor Orbán do të thotë mandati i katërt për kryeministrin hungarez. Nga viti 2010 Orbán e drejton vendin drejt një kursi konfrontimi me BE. Pikat kryesore të grindjes janë politika e azilit, kufizimi i lirisë së mediave, pavarësia

e drejtësisë dhe të drejtat qytetare si edhe keqpërdorimi i fondeve të BE. Orbán e bojkotoi vendimin e BE-së për të pranuar emigrantët në bazë të kuotave. Në fushatën elektorale, Viktor Orbán bëri një politikë kundër emigrantëve duke e kthyer atë në temë qendrore. Sipas tij BE, OKB, dhe miliarderi Soros ndjekin një plan për të futur dhjetëra mijëra emigrantë në Hungari e për ta bërë atë vend imigrimi. Vetëm nëse ai qeveris më tej, kjo mund të ndalet, ashtu si edhe islamizimi i Europës. Opozita e akuzon kryeministrin Orbán për minim të demokracisë dhe shpërndarje të burimeve të BE tek oligarkët e afërt me të.



Republika e Maqedonisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 16 paragrafi 9 të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta Zyrtare RM" nr. 50/2010, 162/2010, 157/2011, 147/2013, 41/2014, 33/2015, 193/2015, 53/2016 dhe 11/2018), Qeveria e Republikës së Maqedonisë publikon

KONKURS PUBLIK Për zgjedhje të kryetarit dhe gjashtë anëtarëve të Këshillit inspektues

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë zgjedhë kryetarin dhe gjashtë anëtarë të Këshillit inspektues, të cilët funksionin do ta realizojnë në mënyrë funksionale.
- Anëtarët e Këshillit inspektues zgjidhen në sferat në vijim:
 - një anëtar në sferën e mbikëqyrjes së tregut, marrëdhënies së punës dhe sigurisë dhe shëndetit gjatë punës,
 - një anëtar të Këshillit inspektues nga sfera e mjedisit jetësor dhe mbrojtjes së shëndetit të njerëzve,
 - një anëtar të Këshillit inspektues nga sfera e ndërtimit, urbanizmit dhe transportit,
 - një anëtar të Këshillit inspektues nga sfera e bujqësisë, pylltarisë, veterinarisë dhe sigurisë së ushqimit,
 - një anëtar të Këshillit inspektues nga sfera e arsimit, shkencës dhe kulturës dhe
 - një anëtar të Këshillit inspektues nga sfera e administratës.
- Për kryetar të Këshillit inspektues zgjidhet personi i cili:
 - është shtetas i Republikës së Maqedonisë që dëshmohe me dëshmi të shtetësisë,
 - ka të arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit nga sfera e shkencave juridike ose ekonomike, që dëshmohe me certifikatë,
 - ka së paku gjashtë vjet stazh të punës në profesion pas diplomimit që dëshmohe me vërtetim për stazh të punës të dhënë nga organi kompetent,
 - posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetër se pesë vjet: TOEFEL iBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English – First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku B2 dhe
 - përdorë programe kompjuterike për punë në zyrë.
- Për anëtar të Këshillit inspektues zgjidhet personi i cili:
 - është shtetas i Republikës së Maqedonisë që dëshmohe me dëshmi të shtetësisë,
 - ka të arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit dhe së paku pesë vjet stazh të punës pas diplomimit në sferën përkatëse për të cilën emërohet, që dëshmohe me certifikatë dhe vërtetim për stazh të punës në sferën përkatëse, të dhënë nga organi kompetent,
 - posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetër se pesë vjet: TOEFEL iBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English – First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku B2 dhe
 - përdorë programe kompjuterike për punë në zyrë.
- Kryetari dhe anëtarët e Këshillit inspektues nuk mund të jenë anëtarë në organe dhe trupa të cilat i zgjedhë dhe emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
- Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët obligohen që të parashtrojnë edhe dokumentacionin në vijim:
 - biografi të shkurtë;
 - certifikatë të shtetësisë;
 - diplomë për arsim sipëror të mbaruar, së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit nga sfera e shkencave juridike ose ekonomike, që dëshmohe me certifikatë dhe dëshmi se ka së paku gjashtë vjet stazh të punës në profesion pas diplomimit që dëshmohe me vërtetim për stazh të punës të dhënë nga organi kompetent – **për kryetar**
 - diplomë për arsim të mbaruar, së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit dhe së paku pesë vjet stazh të punës pas diplomimit në sferën përkatëse për të cilën emërohet, që dëshmohe me certifikatë dhe vërtetim për stazh të punës në sferën përkatëse, të dhënë nga organi kompetent – **për anëtar**.
- Dispozitat nga pika 3 alineja 4 dhe pika 4 alineja 3 do të fillojnë të aplikohen prej më 1 shtator të vitit 2018. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit inspektues të cilët janë të zgjedhur në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimit të Ligjit ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 11/2018) prej më 18 janar deri më 1 shtator të vitit 2018, obligohen të përmbushin kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tyre. Kryetari dhe anëtarëve që nuk do të përmbushin kushtin për njohje të gjuhës së huaj brenda afatit të caktuar u ndërpritet mandati.
- Dokumentet nga pika 3 dhe pika 4 duhet të parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter dhe të njëjtat parashtrohen në arkivin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose përmes postës në adresën: Qeveria e Republikës së Maqedonisë rr."Ilindenska" nr. 2 1000 Shkup me shenjë: "Për konkurs publik për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit inspektues"
- Koeficienti për përllogaritjen e pagesës: 3,9 në pajtim me nenin 16 paragrafi 15 i Ligjit për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta Zyrtare RM" nr. 50/2010, 162/2010, 157/2011, 147/2013, 41/2014, 33/2015, 193/2015, 53/2016 dhe 11/2018).
- Orari i punës është 40 (dyzet) orë në javë, gjegjësisht 8 (tetë) orë në ditë gjatë javës së punës, prej ora 08:30 deri në ora 16:30, prej ditës së hënë deri ditën e premte – orar i plotë i punës.
- Afati për paraqitje është (5) pesë ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit të konkursit publik në gazetën ditore, ndërsa deri më **16.04.2018**.
- Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dorëzuar pas afatit për aplikim nuk do të shqyrtohet.

Në bazë të nenit 17, nenit 18 dhe neni 19 nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira për nxënës të shkollave fillore të MASH nr.07-9992/2 të datës 05.06.2014, SHF "Goce Dellçev" - Konçe shpall

SHPALLJE

për realizimin e procedurës për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve për vitin shkollor 2017/2018

- Organi kontraktues:**
SHF "Goce Dellçev" - Konçe
adresa: f.Konçe, 2424 Konçe
tel: 032/649-145; e-posta: goce_dellcev_konçe@yahoo.com
 - Përshkrimi i shërbimit:**
 - Ekskursion njëditor për nxënësit e klasës së tretë** për 33 nxënës në periudhën e muajit maj 2018
Nisja e grupit para shkollës në orën 07:00 nga f.Konçe - Radovish dhe nisja kah lokacioni i parë për vizitë të "Aeroporti Ndërkombëtar Shkup", në ora 10.00 arrija në aeroport. Në ora 11:00 arrija në Kalanë e Shkupit, vizitë të kishës "Shën Spas"; kalimi nëpër Çarshinë e vjetër, në ora 15.00 nisja kah Kompleksi muzeor Lufta Maqedonase dhe vizita e të njëjtit, në ora 16.00 vizita e shtëpisë përkujtimore të Nënë Terezës dhe në ora 17.00 kthimi prapë kë Konçe. Kthimi i nxënësve deri në vendin e banimit deri te të gjitha vendet e banuara në komunën Konçe.
Në çmimin e ofertës të jenë të llogaritura edhe shërbimet në vijim:
 - transportim me autobusë të lartë turistik në relacionin e cekur,
 - për të gjithë objektet që do te vizitohen në çmim të jetë e llogaritur edhe çmimi i biletës,
 - të siguruar 6 gratisa për mësimdhënësit
 - organi kontraktues e mban të drejtën ta caktoj datën për realizim të ekskursionit,
 - organi kontraktues e mban të drejtën ta ndryshoj numrin e nxënësve varësisht nga interesimi i nxënësve,
 - ekskursionin e financon prindi/kujdestar i nxënësit, me pagesën e mjeteve financiare të subjektit juridik i cili e realizon ekskursionin.
 - Ekskursion dyditor për nxënësit e klasës së gjashtë** për 24 nxënës në periudhën e muajit maj 2018
Dita e 1 - Nisja e grupit para shkollës në orën 06:00 nga f.Konçe kah lokaliteti Stobi, arrija në lokalitetin antik Stobi dhe shikimi i saj, në ora 10.00 nisja drejt Prilepit, vizitë Mogjillën e të pa fituarve me histori të shkurtë të qytetit të Prilepit dhe pauzë për drekë, në ora 14.00 nisja drejt Krushevs, shëtitje dhe shikim të qytetit, vizita e Shtëpisë Memoriale dhe varrit të Tosh Proeski dhe monumentit Makedonium, në ora 17.00 nisja drejt Manastirit dhe akomodim në hotel me darkë.
Dita e 2 - Mëngjes. Pas mëngjesit shëtitje në Shirok Sokak, shikim i qytetit me histori për qytetin e Manastirit, në ora 11.30 nisja drejt lokalitetit Heraklea dhe shikimi i lokalitetit Heraklea, në ora 14.00 pauzë për drekë dhe nga ora 15.00 nisja prap drejt Konçe. Kthimi i nxënësve deri në vendin e banimit deri te të gjitha vendet e banuara në komunën Konçe.
Në çmimin e ofertës të jenë të llogaritura edhe shërbimet në vijim:
 - transportim me autobusë të lartë turistik në relacionin e cekur,
 - për të gjithë objektet që do te vizitohen në çmim të jetë e llogaritur edhe çmimi i biletës,
 - të siguruar 1 gratis për nxënës i cili vjen nga familje e rrezikuar sociale,
 - te siguruar 2 gratisa për mësimdhënësit
 - organi kontraktues e mban të drejtën ta caktoj datën për realizim të ekskursionit,
 - organi kontraktues e mban të drejtën ta ndryshoj numrin e nxënësve varësisht nga interesimi i nxënësve,
 - ekskursionin e financon prindi/kujdestar i nxënësit, me pagesën e mjeteve financiare të subjektit juridik i cili e realizon ekskursionin.
- Përmbajtja e ofertës**
 - Nën pikën 1- për ekskursion njëditor**
 - çmim individual dhe të përgjithshëm për shërbimin sipas përshkrimit të dhënë në pikën 2.1 të kësaj shpallje, me guid të siguruar dhe mjek të siguruar
 - dokumente në pajtim me pikën 4, 5 dhe 6 të kësaj shpallje
 - oferta nuk duhet të përmbajë zgjidhje alternative
 - Nën pikën 2- për ekskursion dyditor**
 - çmim individual dhe të përgjithshëm për shërbimin sipas përshkrimit të dhënë në pikën 2.2 të kësaj shpallje, me guid të siguruar dhe mjek të siguruar
 - dokumente në pajtim me pikën 4, 5 dhe 6 të kësaj shpallje
 - oferta nuk duhet të përmbajë zgjidhje alternative
 - Nën pikën 3- për ekskursion treditor**
 - çmim individual dhe të përgjithshëm për shërbimin sipas përshkrimit të dhënë në pikën 2.3 të kësaj shpallje, me guid të siguruar dhe mjek të siguruar
- dokumente në pajtim me pikën 4, 5 dhe 6 të kësaj shpallje
- oferta nuk duhet të përmbajë zgjidhje alternative
- Kushtet minimale të cilat duhet ti plotësojë ofertuesi:**
 - Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në R.M. për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike,
 - Me sukses të ketë të realizuara së paku 3 ekskursione për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira në 3 vitet e fundit,
 - Të përmbushë kushtet për transport të grupit të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve,
- Dokumentet të cilat duhet ti dorëzojë ofertuesi së bashku me ofertën:**
 - dokument për veprimtari të regjistruar,
 - kopje të marrëveshjeve si dëshmi që ka të realizuar me sukses më së paku 3 ekskursione për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira në 3 vitet e fundit, me vulë nënshkrim dhe shenjë "Besnike ndaj origjinalit"
 - vërtetim për plotësimin e kushteve teknike-eksploatauese për transport
 - deklaratë me të cilën ofertuesi deklaron se i plotëson kushtet për transport të grupit të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve
 - deklaratë për guid të siguruar
 - deklaratë për mjek të siguruar
 - deklaratë që siguron gratis për nxënës i cili vjen nga familje e rrezikuar sociale në pajtim me numrin e cekur në pikën 2 të kësaj shpallje,
 - deklaratë që siguron gratis për mësimdhënësit në pajtim me numrin e cekur në pikën 2 të kësaj shpallje
- Vërejtje: Nëse ofertuesi mer pjesë me ofertë për dy ose për tre ekskursionet, ai është i obliguar të dorëzojë oferta në pliko të veçantë për çdo ekskursion dhe me çdo ofertë dokumentacionin e kërkuar dorëzohet veçmas!**
- Garancion bankar**
Në ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes ofertuesi i zgjedhur dorëzon garancion bankar në vlerë prej 5% nga çmimi i përgjithshëm i vlerës së marrëveshjes, për çdo marrëveshje veçmas.
- Kriteret për dhënie e marrëveshjes për realizimin e ekskursionit:**
Çmimi më i ulët
- Ofertuesi mund të dorëzojë ofertë për një, dy apo për tre ekskursionet veçmas në pliko të veçantë.** Oferta duhet të jetë në pliko të veçantë për çdo ekskursion me shenjë: "Mos e hap" për komisionin për grumbullimin e ofertave dhe e shënuar "Për ekskursion njëditor"; " Për ekskursion dyditor" ose " Për ekskursion treditor".
- Afati i fundit, vendi dhe mënyra e dorëzimit të ofertës:**
Oferta së bashku me dokumentacionin e plotë dorëzohet deri të shkolla në pliko të mbyllur në afat prej 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit të kësaj shpallje. Ofertat e pakompletuara, ofertat me zgjedhje alternative dhe ofertat jo në kohë nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

ASANI PËR MEDIAT NË SHQIPËRI RRËFEN DËSHIRËN E TIJ TË MADHE

ËNDËRROJ TË LUAJ PËR KOMBËTAREN E SHQIPËRISË

"Normal, të gjithë lojtarët me gjak shqiptari kanë dëshirë që të luajnë për Kombëtaren shqiptare. E ëndërroj që fëmijë, por me ndihmën e shokëve të ekipit dhe të klubit do ta kap edhe Kombëtaren shqiptare. Së shpejti do ta realizoj ëndrrën time që të luaj për Kombëtaren e madhe të Shqipërisë, pasi me U-21 e kam provuar", shprehet Asani



Shkup, 9 prill - Jasir Asani ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në suksesin që arriti në fundjavë Partizani në Laç. Ndonëse nuk shënon shumë, ai shërben për shokët dhe krijon panik te kundërshtarët. Në intervistën e dhënë për "Panorama Sport", Asani në rrëfimin e tij tha se ëndrra e tij si fëmijë ka qenë

të luajë për Kombëtaren e Shqipërisë dhe ka besim se do ta realizojë shumë shpejt atë. "Normal, të gjithë lojtarët me gjak shqiptari kanë dëshirë që të luajnë për Kombëtaren shqiptare. E ëndërroj që fëmijë, por me ndihmën e shokëve të ekipit dhe të klubit do

ta kap edhe Kombëtaren shqiptare. Së shpejti do ta realizoj ëndrrën time që të luaj për Kombëtaren e madhe të Shqipërisë, pasi me U-21 e kam provuar", shprehet Asani, i cili tha se ekipi i Partizanit me trajnerin Dalipi është më i lirshëm, dhe se me ish-trajnerin Starova

kanë pasur frikë. Ai gjithashtu shprehu besimin se ekipi e arrin vendin e dytë. Asani në rrëfimin e tij tregon idhullin e tij, si dhe tregon arsyen pse festoi si Françesko Toti pas ndeshjes në Laç. "Po, më pëlqen shumë Dibala. Ai është idhulli im dhe lojtari më i mirë në botë. Edhe Toti më ka pëlqyer si lojtar, por e thashë se idhull kam Dibalën, mbase edhe nga që luajmë në të njëjtin rol. 'Selfien' me tifozët pas ndeshjes e bëra në shenjë respekti ndaj tyre, pasi ata i kemi në çdo ndeshje përkrah. Shpresoj që t'i gëzojmë ata me fitoret tona, të cilat do të vijnë njëra pas tjetrës", deklaroi futbollisti shkupjan. Cekim, Asani te Partizani erdh pas një aventure të shkurtër te Pobeda, ndërsa ka luajtur edhe për FC Shkupin, mirëpo, karrierën më të madhe e kaloi te KF Vardar, ku edhe e filloi karrierën si futbollist, ndërsa nga 66 paraqitjet sa i kishite për ekipin e parë, arriti të shënojë 17-të gola. Ndërkohë, edhe pse ishte pjesë e përfaqësueses së Maqedonisë deri 21 vjeç me të cilën regjistroi katër paraqitje, futbollisti shkupjan vendosi të mbrojë ngjyrat e Kombëtares së Shqipërisë duke regjistruar vetëm një paraqitje për shpresat, ndërsa tani që ka 22 vjeç, ai është në pritje të ftesës nga seleksionuesi aktual i Kombëtares së Shqipërisë, Kristian Panuçi.



Festë në kohën shtesë për Bardhin dhe Sadikun

Festë në Valencia, krahu i Levantes së vogël. Klubi ku luajnë Armando Sadiku e Enis Bardhi ka arritur një fitore të artë 2-1 kundër Las Palmasit, në një finale mbijetese. Fitorja e Deportivos të premtën detyronte Levanten të luante për fitore, ose të paktën për të mos humbur, ndërsa Las Palmasi, i parafundit në renditje, luante shansin e fundit dhe vetëm fitorja e ringjallje. Sadiku e nisi nga stoli, ndërsa Levante e mbylli pjesën e parë në avantazh. Në fillim të pjesës së dytë Las Palmasi barazoi dhe në minutën e 63-të erdhi momenti i sulmuesit kuqezi, i hedhur në fushë në vend të Pacini. Pak më vonë u fut edhe Bardhi. Presion i madh, nervat në kulm, karton i kuq për Levanten 5 minuta para fundit, por festa shpërtheu në minutën e 92-të, kur Kamara shënoi golin që vlen qëndrimin në La Liga, sepse Deportivo është 8 pikë larg.



Lenjanin e zgjedhin si më të mirin

Emir Lenjani i është rikthyer nivele të larta në kampionatin zviceran, teksa është zgjedhur te futbollistët më të mirë të javës së 28-të. Në takimin e mbijetësës që Sioni fitoi ndaj Lausanes në transfertë me rezultatin 0-2, nuk mungoi protagonizmi i Emir Lenjanit. Futbollisti i Kombëtares ishte protagonist kryesor në këtë ndeshje, teksa fitoi penalltinë dhe rastin e golit të parë dhe asistoi në të dytin. Faktikisht, Lenjani është një nga mbrojtësit më në formë të kombëtares shqiptare, por kjo nuk ka mjaftuar që Panuçi t'i besojë një vend në formacion.

QATIP OSMANI FLET PAS FITORES NDAJ RENOVËS

Fitore bindëse e arritur me lojë të mirë

Shkup, 9 prill - Skuadra e Shkëndijës javën që e lamë pas bërë hapin e radhës drejt sigurimit të titullit të kampionit në Ligën e Parë të futbollit të Maqedonisë, pas fitores bindëse 5:0 përballë Renovës në kuadër të xhiros së 26-të. Me mungesa të disa lojtarëve titullar në formacion (Hasani, Ibraimi, Alimi, Adili dhe Vakili), kuqezinjtë shfaqën inspirim në fushë me futbollistët që treguan se janë të gatshëm kurdo që tu jepet shansi për të luajtur. Kjo ka lënë të kënaqur trajnerin Osmani që vlerësoi paraqitjen dhe fitoren bindëse të skuadrës, reagimin e futbollistëve që morën besimin për të luajtur, debutimin e Leard Sadiut, rikthimin e Arbin Zejnullait dhe serinë prej 7-të ndeshjeve të njëpasnjëshme në kampionat pa gol të pranuar. "Fitore bindëse e arritur me lojë të



mirë e cila rezultoi me pesë gola. Shkëndija sot luajti ndoshta ndeshjen më të mirë në këtë gjysmëkampionat. Shkëndija duhet çdoherë të luajë kështu, pasi ki-

shte aksione të bukura dhe gola ashtu që jam i kënaqur dhe uroj lojtarët për fitoren e arritur", deklaroi trajneri Qatip Osmani. Ndeshjen e ardhshme Shkëndija do

të luan përsëri ndaj Renovës, por tani në kuadër të ndeshjes kthyesë të Kupës së Maqedonisë, ku ndeshja e parë gjysmëfinale përfundoi baras 1-1.

76 NDESHJE PËR 6 TITUJ KAMPION!

KARRIERA “E BEKUAR” E KOMAN

Vidal është 31 vjeç dhe mund të jetë normale të ketë fituar kaq shumë, por bën shumë përshtypje palmaresi i Kingslej Koman. Sulmuesi i ri francez, që do të mbushë 22 vjeç në qershor, ka në raftin e trofeve të tij plot 14 tituj, mes të cilëve shtatë janë kampionate. Kurioziteti është që ai ka triumfuar në Ligue 1, Serie A dhe Bundesliga, për gjashtë vite me radhë



ka arritur kuotën e shtatë kampionateve kombëtare radhazi dhe tani më kiliani është futbollistë që ka fituar më shumë në të gjithë historinë. Vidal është 31 vjeç dhe mund të jetë normale të ketë fituar kaq shumë, por bën shumë përshtypje palmaresi i Kingslej Koman. Sulmuesi i ri francez, që do të mbushë 22 vjeç në qershor, ka në raftin e trofeve të tij plot 14 tituj, mes të cilëve shtatë janë kampionate. Kurioziteti është që ai ka triumfuar në Ligue 1, Serie A dhe Bundesliga, për gjashtë vite me radhë. Në të vërtetë në tre nga këto gjashtë kampionate thuhet nuk ka kontribuar aspak. Ai luajti vetëm tre ndeshje me PSZH në sezonin 2012-13 dhe në sezonin 2013-14, ndërsa luajti vetëm një ndeshje kundër Udinese, në Serie A 2015-16, pak ditë para transferimit te Bajerni. Pikërisht ato pesë minuta që i dha Alegri i dhanë mundësinë Koman që në atë sezon të fitonte dy tituj, në Itali e Gjermani, ku luajti 22 ndeshje. Bilanci total është 79 ndeshje në karrierë dhe 6 tituj kampion. Pak lodhje, shumë rezultat dhe më pas festë titulli.



Po i shqyrtoj të gjitha mundësitë

Arjen Robben ka zbuluar se po konsideron të gjitha ofertat nga klubet e tjera, pavarësisht se fitoi titullin e 11-të gjatë karrierës së tij, teksa Bajerni Munihi u confirmuar kampion i Bundesliga. 34-vjeçari Robben, i cili shënoi golin e tretë në fitoren 4-1 ndaj Augsburg, ditën e shtunë, e ndihmoi skuadrën bavareze të fitojë titullin e gjashtë radhazi në Bundesligë, i shtati për të me ekipin gjerman ku luan që nga vitit 2009. Në qershor, holandezi do të jetë i lirë nga çdo lidhje kontraktuale sepse i përfundon marrëveshja me Bajerni Munihi. “Skuadra të tjera më kanë kontaktuar”, – tha Robben që e ka fituar titullin kampion edhe në Angli e Spanjë si pjesë e Çellsit dhe Real Madridit. “Do të vendos me qetësi, por e pranoj se aktualisht nuk është vetëm Bajerni në mendjen time, kur më duhet të mendoj për të ardhmen. Për mua është e rëndësishme të ruaj përqendrimin në muajin e futbollit të sezonit, më pas do të shqyrtoj të gjitha ofertat që kam në tavolinë. Në futboll gjithçka mund të ndodhë”, – deklaroi sulmuesi që ka fituar Çampions Ligën me Bajernin në vitin 2013.

Bajerni Munihi ka fituar titullin e gjashtë radhazi dhe një grup i futbollistëve të tyre vazhdojnë të thyjnë rekorde. Klubi më i pasuar, më i fuqishëm, me më shumë trofe, vazhdon të dominojë kampionatin gjerman që nga viti 2012. Ndryshojnë trajnerët, nga Hejnk

te Hejnkës, duke kaluar nga Guardiola e Anceloti, por në Bundesliga nuk ka asnjë konkurrencë, ndërsa në Çampions bavarezët e kanë të vështirë të bëjnë ligjin, edhe pse këtë herë janë shumë pranë gjysmëfinaleve dhe mbajnë të freskët kujtimin e “tripletës” në vitin 2013.

Disa futbollistë të Bajerni nuk po gjejnë më vend për të vendosur trofetë, por mbi të gjithë, dy prej tyre janë abonuar me titullin. Njëri është prej tyre është Arturo Vidal, që duke konsideruar edhe katër kampionatet e fitues me Juventusin nga viti 2011 në vitin 2015,

Pokettino merr vendimin për të ardhmen

Maurisio Pokettino është një nga trajnerët më të kërkuar dhe disa nga skuadrat më të mëdha në Evropë, kryesisht jashtë Anglisë, ia kanë “shkelur syrin” trajnerit të Tottenhamit. Por argjentinas ka bërë fashuar të gjithë me deklaratën e tij, kur ka thënë se nuk ka ndërmend të largohet nga Premier Liga dhe se do të respektojë kontratën që ka me Tottenhamin. “Dua të përmirësohem nga viti në vit. Kam firmo-

sur një kontratë 4-vjeçare dhe që kur kam ardhur jam përpjekur që të reduktoj diferencën me skuadrat e mëdha në Premier. Dhe, mbi të gjitha, jam përpjekur që të krijon një projekt për të qenë gjithnjë kompetitivë, të kemi një stadium të ri, për të qenë një ekip pretendent edhe në Çampions Ligë”, tha Pokettino. Më tej, trajneri 46-vjeçar, shtoi. “Projekti me stadiumin po shkon mirë dhe unë e klubi kemi të njëj-

tin vizion, për të vazhduar së bashku edhe në të ardhmen. Projekti që kemi nisur është shumë tërheqës, për të tashmen dhe ardhmen, ndaj dua të qëndroj këtu”, deklaroi Pokettino. Mediat britanike shprehin gjithashtu se presidenca e Tottenhamit ka gati një kontratë të re për trajnerin argjentinas, duke i ofruar 10 milionë euro për sezon, shumë që do të largojë pretendentët.



Publicitet

Këshilli i shkollës së SHFK “Sv. Kiril i Metodi” nga Velesi, në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 06/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015 dhe 30/2016) publikon:

SHPALLJE PUBLIKE 1/2018

Për zgjedhje të drejtorit të SHFK “Sv. Kiril i Metodi” nga Velesi

Krahas kushteve të përgjithshme kandidati duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- të ketë të mbaruar së paku arsimin sipëror dhe të përmbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në arsim fillor
- të ketë së paku (5) pesë vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimorë
- të ketë të dhënë provimin për drejtor
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- të ketë të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet

Kandidati së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojë dëshmi për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme edhe atë:

- Certifikatë të shtetësisë,
- Certifikatë të mjekut,
- Diplomë për arsim të mbaruar,
- Vërtetim për përvojë të punës,
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor,
- Certifikatë për vendim të plotfuqishëm gjyqësor se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe
- Vërtetim për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.
- Së bashku me fletëparaqitjen kandidati duhet të parashtrojë edhe Program për punë për periudhë prej katër vjet.

Afati për paraqitje është (6) gjashtë ditë pune nga dita e publikimit të fundit në shtypin ditor (duke mos konsideruar ditën e publikimit).

Fletëparaqitjen e plotësuar me biografi të shkurtë, së bashku me dëshmitë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme kandidati është i obliguar që ti parashtrojë deri te Këshilli i shkollës së SHFK “Sv. Kiril i Metodi” nga Velesi drejtpërdrejt ose përmes postës me shenjë “Për shpallje nr. 1/2018” në adresën në vijim: Arhiepiskop Mihail 156 – Veles.

Fletëparaqitja e dorëzuar pas afatit ose të paplotësuar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi. Dokumentet e arritura në origjinal ose kopje të vërtetuar anë noter të kandidatëve do të shqyrtohen nga ana e Komisionit të formuar nga Këshilli i shkollës në afat prej (5) pesë ditë pas përfundimit të shpalljes publike. Këshilli i shkollës në afat prej (7) shtatë ditë nga biseda e realizuar me kandidatët Kryetarit të Komunës do t’i propozohen dy kandidatë për zgjedhje të drejtorit nëse në shpalljen publike janë paraqitur më shumë kandidatë. Zgjedhjen e drejtorit do ta realizojë Kryetari i Komunës së Velesit.

Këshilli i shkollës

Nurmagomedov ka një mesazh për MekGregor

Kampioni i peshës së lehtë në UFC Khabib Nurmagomedov ka kaluar një javë të tensionuar. Në fillim për shkak të dëmtimit të Toni Ferguson dhe më pas për sulmin e MekGregor gjatë ditës së medias në UFC. Por, tani gjithçka ka shkuar mirë dhe ai më në fund është kurorëzuar kampioni i padiskutueshëm i UFC dhe ka një mesazh për MekGregor: Kemi hesape për të larë,” shprehet ai për gazetarët në konferencën për shtyp pas ndeshjes. “Ai duhet të mos hajë aq shumë ‘Burger King’. A do të luftosh? Eja. Ju kam thënë që do ta bëj një njeri të përlulur. Do ta ndryshoj këtë sport. Tani ka vetëm një kampion. Nuk ka më kampionë falsë, nuk ka më kampionë që nuk mbrojnë tituj. Tani UFC ka një kampion, një kampion që do të mbrojë titullin. A do të luftosh? Eja. Më thuhet ku dhe kur, pa kamerat, pa media dhe pa UFC”, deklaroi Nurmagomedov. UFC 223 u zhvillua në Brukllyn në orët e para të mëngjesit në “Barclays Center”.



Me atë që ka treguar kjo skuadër këtë sezon, është optimiste se mund të arrijë një përmbysje të çmendur në "Etihad". Derisa, futbollistët e Liverpoolit pavarësisht epërsisë së madhe që e kanë, thonë se në "Etihad" nuk shkojnë për t'u mbrojtur, por do të mundohen të përsërisin fitoren 3-0 të ndeshjes së parë

Mançester Siti para një jave mori një lëksion futbollit nga Liverpooli në duelin e parë çerekfinal të Ligës së Kampionëve, ku u mund me shifrat 3-0. Derisa, sot (e martë) të përzgjedhurit e trajnerit Pep Guardiola do të tentojnë të përmbysin këtë epërsi dhe shprejnë që do të jenë ata të cilët do të plasohen në gjysmëfinale. Te Siti besojnë se mund të kualifikohen dhe këtë do ta provojnë në 90-minutat që ju kanë mbetur. Pra, me atë që ka treguar kjo skuadër këtë sezon, është optimiste se mund të arrijë një përmbysje të çmendur në "Etihad". Dhe ai që i kishte lëshuar sfidën Mohamed Salahut për çmimin e lojtarit më të mirë të sezonit në Angli, por e humbi duelin në "Anfield", ka ende besim. Kevin De Bruene pranon se "qytetarëve" do t'u duhet diçka magjike të martën në shtëpi për t'ia dalë, por ai është optimist. "Mendoj se e nisëm mirë, por ata patën katër shanse dhe shë-

LIGA E KAMPIONËVE, NDESHJET KTHYESE ÇEREKFINALE

SITIT I DUHET DIÇKA MAGJIKE PËR TË ELIMINUAR LIVERPULIN



DYSHET:

MANÇESTER S. - LIVERPUL (0-3)
ROMA - BARCELONA (1-4)

*NË KLLAPA JANË REZULTATET
NGA NDESHJET E PARA

nuan tre gola, kështu që u bë e vështirë. Por ne krijuam shumë më pas dhe luajtëm mirë. Nuk i dihet kurrë, është futboll", tha belgu. "Unë kam besim te skuadra jonë dhe mënyra sesi luajmë futboll. Nëse duam që të kualifikohemi në gjysmëfinale, atëherë na duhet diçka speciale. Por në mes janë 90

minuta dhe nuk janë pak. Gjatë kësaj kohe mund të ndodhë gjithçka. Megjithatë, favoritët e mëdhenj tani janë ata. Tani duhet të pishojmë, sepse të shtunën kemi një ndeshje shumë të rëndësishme", deklaroi De Bruene.

Në anën tjetër, futbollistët e Liverpoolit pavarësisht epërsisë së

madhe që e kanë, thonë se në "Etihad" nuk shkojnë për t'u mbrojtur, por do të mundohen të përsërisin fitoren 3-0 të ndeshjes së parë. Kështu mendon edhe mbrojtësi Van Dijk, sipas të cilit ekipi i tij do të sulmojë edhe në "Etihad". "Kemi diskutuar planin e lojës në ditët e kaluara, dhe mendoj se duhet të

bëjmë atë që dimë të bëjmë më mirë. Nuk kemi pse të shkojmë aty dhe të mbrohemi, thjesht duhet të luajmë lojën tonë ashtu siç bëjmë në ndeshjen e kthimit. Do të jetë një ndeshje shumë e vështirë dhe unë mezi po e pres", shprehet ai për faqen zyrtare të Liverpoolit.

Ndërkohë, Barcelona pas fitores 4-1 në "Nou Camp" ndaj Romës, është me një këmbë në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Duke marrë parasysh ecurinë e katalonave dhe rezultatet që po i arrin në Primera Divizion, kurse Roma në këtë ndeshje hyn pas humbjes së papritur në shtëpi nga Fiorentina, të bën të mendosh se një përmbysje në këtë përballje, vështirë se mund të ndodhë. "Nuk e di nëse mungon mentaliteti për këto ndeshje, por ata janë më të fortë dhe kjo dihet. Rezultati 3-1 do të ishte më mirë, por kur bëhen kaq shumë gabime, këto ekipe të mëdha të ndëshkojnë. Në këtë ndeshje hymë pas një humbje të rëndë nga Fiorentina ku ende nuk e kemi siguruar pjesëmarrjen në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Por do të shohim se çfarë mund të bëjmë sonte ndaj Barcelonës", deklaroi Edin Xheko, autori i golit të vetëm për Romën në "Camp Nou". Të dyja ndeshjet kthye do të fillojnë në ora 20.45.

Asistentja ofendohet nga tifozët



Asistentja e vetme e Bundesligas Bibi Steinhaus është korigjuar plot dy herë nga VAR gjatë fitores 2-1 të Gladbah ndaj Herta Berlin. Në rastin e parë ishte pozicioni jashtë loje i Herrmann i cili duhej anuluar. Më pas ishte faulli i qartë brenda zonës së Lustenberger kundrejt Elvedit. Më pas vjen skena skandaloze kur një grup nga vendi ku po rrinin tifozët e Gladbach që e quajtën "kurvë" anësoren Steinhaus. "Ne si klub

duhet të kërkojmë falje për ofendimet e ardhura nga tifozët tani. I kërkojmë falje Steinhaus. Është një budallallëk dhe nuk duhet të ndodhë në fushat e futbollit," shprehet menaxheri i Gladbah Eberl. Por të paktën vetë Bibi nuk e ka vënë re incidentin. "Në fakt as nuk e kam vënë re. Fokusi dhe përqendrimi im në fushë ishte shumë i madh dhe unë e kam mendjen se çfarë ndodh në fushë", deklaroi Bibi.

Diçka e madhe pritet të ndodhë mes Nejmarit dhe Messit

Diçka e madhe mes Nejmar dhe ish-bashkëlojtarit të tij te Barcelona, Lionel Messi, duket se po ndodh. Kjo, sipas yllit të PSZH-së, Nejmar, i cili u largua nga "Camp Nou" në gushtin e vitit të kaluar për një shifër rekord prej 222 milionë eurosh. Nejmar, që është duke u rikuperuar pas operacionit në këmbë, para Kupës së Botës në Brazil, postoi një mesazh të fsheshtë në "Twitter", të dielën. Në një "tweet", duke përfshirë edhe një fotografi të çiftit, Nejmar shkroi: "Kur unë dhe miku im, Leo Messi, të mbledhim gjëra të mrekullueshme, do të tregoj më shumë. Së shpejti, qëndroni të sintonizuar!"

Mbetet për t'u parë nëse mesazhi përfshin bashkimin e duetit në fushën e lojës, apo braziliani iu referohet çështjeve komerciale. Ndoshta kjo gjë lidhet edhe me diçka tjetër, krejtësisht. PSZH ta-



shmë ka shumë "fuqi zjarri", me Nejmar, Kylian Mbappe dhe Edinson Kavani, që kryesojnë sulmin parisien. Leo Messi, pesë herë fituesi i "Topit të Artë", shënoi një "hat-trick" në fitoren 3-1 kundër Leganes, në La Liga, duke u ngjitur në kuotën e 39 golave, në të gjitha garat, këtë sezon. Ndërkohë, Nej-

mar ka dominuar Ligue 1 këtë vit, duke shënuar 19 gola dhe dhënë 13 asistime në vetëm 20 ndeshje të luajtura. Por, PSZH-ja, pa të, të dëmtuar, u eliminua që në 1/8 finale të Ligës së Kampionëve, nga Real Madridi. Ylli i Brazilit luajti vetëm ndeshjen e parë, në "Bernabeu", por e humbi kthimin.

Dhuruesit e spermës duhet të jenë komunistë



Të jesh nga 20 deri në 45 vjeç, të kesh shëndet të mirë, të bësh analiza periodike për të garantuar mungesën e infeksioneve e të tjera si këto, janë mes kushteve të shumta për të qenë një dhurues sperme. Por, një bankë sperme në Pekin ka vendosur që ta çojë në një tjetër nivel sigurinë në këtë fushë, duke kërkuar që dhuruesit të jenë besnikë të Partisë Komuniste. Spitali i tretë i Universitetit Pekin, në një komunikatë të tij, lajmëroi se dhuruesit e mundshëm duhet të dashurojnë edhe atdheun socialist. Lajmërimi për kandidatët e mundshëm premtan edhe 5500 juan (872 dollarë) për ata që do të kalojnë testet e shumta, pjesa dërrmuese e

të cilave plotësisht të arsyeshme, ndërsa në sy ranë pikërisht kërkesat politike. Në komunikatën që mediat raportojnë se tashmë është ndryshuar, kërkohej që dhuruesit potencialë të kishin cilësi të favorshme politike. Dhuruesit, sipas spitalit, duhet patjetër të mbështesnin lidshërinë e Partisë Komuniste, të ishin besnikë të kauzës së partisë dhe të mos kishin probleme politike. Nuk është e qartë se si spitali planifikon të verifikojë besnikërinë ideologjike të dhuruesve të spermës, të cilët, sipas bankave të spermës në Kinë, janë në mungesë të madhe, sidomos pas lehtësimit të politikës me vetëm një fëmijë nga qeveria kineze.

Gjeorgjia ua ndalon zyrtarëve automobilat e zinj



Qeveria e Gjeorgjisë ua ka ndaluar zyrtarëve qeveritarë të voziten në automobila me ngjyrë të zezë. Kryeministri Giorgi Kvirikashvili tha se ky hap paraqet fundin e erës së xhipave të zi dhe kalimin në transportin e pranueshëm shoqëror. Të gjitha shërbimet shtetërore janë të obliguara të paraqesin planin për blerjen e veturave të reja, ndërsa një pjesë e flotës do të jenë modele të pranueshme ekologjike. Në fillim të këtij viti, Turkmenistani ndaloi përdorimin e automobilitave të zi për të gjithë qytetarët, por arsyeja në këtë shtet ishte ndryshe - ngjyra e zezë "shkakton" aksidente.


Debat shtetëror për "veshgjatët" e papunë



Dikur ishin një kafshë fisnike, e respektuar nga njeriu, që e shfrytëzonte atë në transport, bujqësi dhe në shumë aktivitete të tjera të përditshmërisë së vet. Por sot, teknologjia, ashtu si shumë gjëra të tjerë ka nxjerrë "demode" edhe gomerët. Kjo ka ndezur një debat të pashembull në Brazil, një ndër vendet me popullsinë më të madhe të "veshgjatëve". Mijëra gomerë kullosin në lëndinat e gjëra të vendit amerikano-juqor, të papunë, ndërkohë që autoritetet diskutojnë për fatin e tyre. Një propozim është ai për therjen dhe më pas transportin e mishit të tyre për konsum

në tregun "e uritur" kinez, propozim që ka ngjallur kundërshtimin e fortë të tradicionalistëve, që kërkojnë ruajtjen e tyre, transmeton tch. Ka disa grupe të tjera që propozojnë sterilizimin, në mënyrë që kafshët të mos shtohen më dhe të mos shkaktojnë problemin e mbipopullimit. Brazili nuk është i vetmi vend që ndodhet përballë kësaj dileme. Edhe në Kenia po zhvillohet një debat i ngjashëm, por ndryshe nga eksporti për në Kinë, në vendin afrikan po diskutohet shfrytëzimi i këtyre kafshëve për të ushqyer mishngrënësit e egër të xhunglës.

Pse sot nuk rriten më "gjeni"?



Përgjatë gjithë shekullit XX, inteligjenca - ose më saktë kuocienti i inteligjencës (ideuar nga Alfred Binet) vetëm u rrit, në pjesë të ndryshme të botës. Është i ashtuquajtur i efekti Flynn, nga

emri i studiuesit James Flynn i cili ka përshkruar se si, përgjatë gjithë Nëntëqindës, Kuocienti mesatar i popullsisë të ndryshme është rritur me tre pikë për çdo dhjetë vjet. Kjo nuk do të thotë që

njëqind vjet më parë ishim të gjithë më budallenj. Është e mundur që ky efekt nxjerr në dritë rritjen e ndonjë përbërësi të Kuocientit, i cili është më lehtësisht i ndikueshëm prej kushteve mjedisore, si aftësia e mendimit abstrakt.

Është e mundur që në fillim të shekullit që kaloi, kur njerëzit ishin mesatarisht më pak të arsimuar dhe kishin më shpesh të bënin me probleme praktike, që lidheshin me punën në fusha apo në fabrika, kjo aftësi të ishte më pak e zhvilluar se sa sot. Investigime të kohëve të fundit të kryer në disa vende, duket megjithatë se sugjerojnë që Kuocienti i Inteligjencës ka pushuar së rrituri, madje ka nisur edhe të bjerë.

879 - Lui III kurorëzohet Mbret i Francës.

1589 - Trupat spanjolle okupojnë Geertruidenberg.

1739 - Dick Turpin ekzekutohet në Angli për vjedhje të kuaive.

1825 - Hapet hoteli i parë në Havai.

1864 - Arkiduka austriak Maximilian bëhet perandor i Meksikës.

1869 - José Martí themelon Partinë Revolucionare të Kubës.

1887 - Kryetari Abraham Lincoln rivarrosset me gruan e tij në Springfield Illinois.

1944 - Sovjetikët çlirojnë Odesën nga nazistët.

1957 - Kanali i Suezit rihapet për tërë trafikun.

2010 - Aeroplani polak Tu-154M rrëzohet afër Smolensk në Rusi. Vdesin të gjithë 96 pasagjerët, duke përfshirë edhe Kryetarin polak, Lech Kaczyński.

Në Rusi janë gati 200 pakica kombëtare dhe etnike. Me e madhja është ajo Tatare, e cila përfaqëson rreth 4 për qind të popullsisë.



Bolshevikët rus ishin ateistë dhe feja ishte anuluar nga shteti i ri rus. Ajo u shtyp për tre gjenerata deri në vjeshtën e Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, kur ka bëri kthimin e tij.



Përpara revolucionit Rusia ishte një shoqëri në pjesën më të madhe të bujqësore; Në fillim të vitit 1900 katër rusë në pesë ishin fermerë. Ishin të varfër, pa arsim, supersticioz dhe analfabet.



LIBRI

Burri: Ku ma ke lënë librin "Si të jetosh 100 vite"?

Gruaja: E dogja, sepse filloi ta lexonte nëna jote...



Kam zbuluar për kënaqësinë time, se është jeta, jo vdekja, ajo që nuk ka kufij. (Gabriel García Márquez)



KALENDARI HISTORIK 10 PRILL



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS